



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Raporti Vjetor 2020



Rrjeti i Grave të Kosovës

Raporti Vjetor 2020



© Rrjeti i Grave të Kosovës, 2020

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Ky publikim mund të kopjohet dhe të shpërndahet në tërësi apo pjesërisht, duke cituar burimin.

Ky raport është përgatitur nga anëtarët e stafit të Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK), të përkrahura nga Bashkimi Evropian (BE), Agjencioni Austriak për Zhvillim (ADA), UN Women, Fondacioni Kvinna till Kvinna, Agjencioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA), dhe Sweden Sverige si përgjegjësi e RrGK-së për të raportuar tek organizatat anëtare të saj. Përmbajtja e këtij raporti është vetëm përgjegjësi e RrGK-së dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron qëndrimin zyrtar të donatorëve të lartpërmendur.

www.womensnetwork.org



Përmbajtja

Hyrje.....	7
Vizioni ynë.....	7
Misioni ynë	7
Strategjia jonë.....	7
Rreth Raportit Vjetor të RrGK-së.....	8
Fuqizimi i Lëvizjes Feministe në Kosovë	9
Të krijohet një strategji për avancimin e lëvizjes feministe dhe të bëhet progres drejt zbatimit të saj	10
Rritja e solidaritetit në mes të organizatave të grave	10
Përmirësimi i kapacitetit organizativ dhe avokues të RrGK-së dhe anëtareve të saj drejt qëndrueshmërisë afatgjatë të tyre	13
Përmirësimi i klimës së financimit për organizatat për të drejtat e grave.....	23
Gratë në Politikë dhe Vendimmarrje	27
Rritet dhe përmirësohet pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendimmarrje në nivel lokal dhe qendror sipas Ligjit për Barazi Gjinore (50%)	27

Përmirësimi i integritetit të çështjeve gjinore në dokumentet që lidhen me anëtarësimin e Kosovës në BE dhe me zbatimin e tyre	42
Përmirësimi i zbatimit të PVGJ II	45
Përmirësimi i projektimit të PVGj III, bazuar në mësimet e nxjerra nga PVGj II.....	47
Të drejtat e grave në kujdesin shëndetësor	49
Jeta pa dhunë me bazë gjinore	50
Fuqizimi Ekonomik i Grave.....	64
Vlerësimi i punës së RrGK-së.....	71
Raporti financiar i RrGK-së për vitin 2020	72
Rreth nesh.....	80
Bordi i Drejtorëve të RrGK-së.....	83
Bordi Këshillëdhënës i RrGK-së	83
Stafi i RrGK-së në vitin 2020.....	83
Kontributet individuale për RrGK-në.....	86
Organizatrat anëtare të RrGK-së	86
Shtojca 1a. Grantet e Fondit të Grave të Kosovës për Anëtarët e RrGGK-së	97
Shtojca 2. Të arriturat e Avokimit nga Lobi për Barazi Gjinore në Kosovë në vitin 2020	136



Hyrje

Vizioni ynë

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) ka një vizion për një Kosovë në të cilën gratë dhe burrat janë të barabartë dhe kanë mundësi të barabarta për arsimim, punësim, pjesëmarrje politike, kujdes shëndetësor dhe një jetë pa dhunë.

Misioni ynë

Misioni i Rrjetit është që të përkrahë, të mbrojë dhe të promovojë të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në tërë Kosovën, pavarësisht nga bindjet e tyre politike, feja, mosha, niveli i arsimimit, orientimi seksual dhe aftësitë. RrGK përmbush misionin e saj përmes shkëmbimit të përvojave dhe informatave, partneriteteve dhe rrjetëzimeve, hulumtimeve, avokimit dhe të shërbimeve.

Strategjia jonë

Për të përmbushur vizionin dhe misionin e tij, RrGK ka hartuar Strategjinë për periudhën 2019-2022 (të cilën mund ta gjeni në [faqen tonë të internetit](#)). Qëllimi i kësaj strategjie është të drejtojë punën e RrGK-së gjatë kësaj periudhe. Strategjia është përpiluar në vitin 2018 me të dhëna nga organizatat anëtare të rrjetit, Bordi i Drejtorëve, partnerët dhe palët tjera relevante. Kjo strategji e RrGK është e ndarë në gjashtë fusha programore: I) Fuqizimi i lëvizjes feministe në Kosovë; II) Gratë në politikë dhe vendimmarrje; III) Të drejtat e grave në kujdesin shëndetësor; IV) Jeta pa dhunë me bazë gjinore, V) Fuqizimi ekonomik i grave, dhe VI) Përmirësimi i qasjes në edukim cilësor dhe të ndjeshëm gjinor.



Rreth Raportit Vjetor të RrGK-së

Çdo vit Rrjeti raporton te organizatat anëtare, partnerët dhe miqtë lidhur me përparimin që është bërë drejt arritjes së objektivave strategjike. Ky raport është i ndarë në gjashtë pjesë në të cilat përfshihen objektivat afatgjata të rrjetit:

- Fuqizimi i lëvizjes feministe në Kosovë;
- Gratë në politikë dhe vendimmarrje;
- Të drejtat e grave në kujdesin shëndetësor;
- Jeta pa dhunë me bazë gjinore;
- Fuqizimi ekonomik i grave;
- Përmirësimi i qasjes në edukim cilësor dhe të ndjeshëm në aspektin gjinor.

Në këtë raport, prezantohen të arriturat dhe rezultatet për vitin 2020, lidhur me secilin nga këto programe. Pjesët e mëposhtme përmbajnë informata lidhur me progresin e arritur drejt çdo objektiivi dhe rezultati të pritur si dhe informata rreth buxhetit, mbështetësve, bordit të drejtorëve, bordit këshillëdhënës, stafit, praktikantëve, vullnetarëve, anëtareve dhe përfituesve të granteve.



Fuqizimi i Lëvizjes Feministe në Kosovë

Qëllimi kryesor i këtij objekti është që të fuqizohet lëvizja feministe ekzistuese në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit. RrGK ka shënuar përparim drejt përmbushjes së këtij objekti, siç tregohet edhe nga treguesit e mëposhtëm:

- RrGK ka zbatuar afërsisht 68% të Strategjisë;
- Gratë dhe burrat kanë ndërmarrë shtatë nisma, 39 që nga viti 2015, për të mbështetur lëvizjen e grave, duke dëshmuar kështu që gjeneratat e ardhshme kanë kapacitet që të vazhdojnë këtë punë; dhe
- Anëtarët e RrGK-së dhe Lobit për Barazi Gjimore në Kosovë kanë vazhduar të jenë tejet aktive dhe të zëshme.

Për realizimin e këtij qëllimi afatgjatë, është bërë përparim drejt objektivave të renditura më poshtë. Ato më poshtë janë të detajuara në tituj të theksuar.



Të krijohet një strategji për avancimin e lëvizjes feministe dhe të bëhet progres drejt zbatimit të saj

Këtë vit, përgjatë tri ditëve me 21-23 tetor, RrGK organizoi punëtorinë për planifikimin e strategjisë feministe, në Durrës, Shqipëri. Duke i respektuar masat mbrojtëse kundër COVID-19, rreth 90 organizata anëtare të RrGK punuan së bashku për hartimin e strategjisë feministe. Strategjia do të finalizohet së shpejti dhe RrGK do të filloj ta zbatoj atë së bashku me organizatat anëtare të saj.

Rritja e solidaritetit në mes të organizatave të grave

Përvoja e RrGK-së sugjeron se mbështetja dhe mirëmbajtja e solidaritet ndërmjet organizatave të grave është jetike në krijimin e një lëvizje feministe të qëndrueshme. Në këtë drejtim, RrGK ka shënuar përparim drejt arritjes së objektivave të vitit 2020. Kjo

dëshmohet nga 69 partneritete, koalicionë dhe nisma të përbashkëta të ndërmarra gjatë këtij viti, si dhe 38 nisma ndëretnike (198 që nga viti 2015). Rezultatet e përpjekjeve të këtij viti renditen më poshtë.



Anëtarët e RrGK bashkëpunojnë në hartimin e një strategjie feministe, Durrës, tetor, 2020



Anëtarët e RrGK-së të informuara për nismat e anëtareve tjera, aktivitetet e RrGK-së, mundësitë e financimit dhe informacione tjera

Këtë vit, anëtarët e RrGK-së ishin të informuara mirë për iniciativat, aktivitetet e RrGK-së dhe mundësitë për përfitim të fondeve. Për shkak të pandemisë COVID-19, anëtarët e RrGK-së nuk mund të takoheshin personalisht. Prandaj, RrGK mbajti tri takime të rregullta tremujore të anëtareve dhe Kuvendin Vjetor të Anëtareve përmes Zoom, ku 138 anëtare, partnerë dhe mbështetës të ndryshëm shkëmbyen informata dhe u informuan për aktivitetet e vazhdueshme të RrGK-së dhe organizatave të tjera anëtare. Që nga viti 2015, gjithsej 1,197 gra dhe burra kanë marrë pjesë në takimet e RrGK-së. Përgjatë këtyre takimeve, anëtarët e RrGK-së luajtën një rol të rëndësishëm në zbatimin e përbashkët të strategjisë, diskutimin e zhvillimeve socio-politike në Kosovë, si dhe në mbikëqyrjen dhe vlerësimin e punës së RrGK-së.

Më shumë aktivistë dhe aktiviste të përfshirë në lëvizjen feministe

Gjatë vitit 2020, RrGK ka angazhuar rreth 300 vajza dhe djem përmes punës vullnetare, Lobit për Barazi Gjinore në Kosovë dhe aktiviteteve të tjera. Kjo u ka dhënë atyre mundësi që të përfitojnë më shumë aftësi rreth organizimit, hulumtimit, avokimit, integritit të çështjeve gjinore në avokimet për të drejtat e njeriut, monitorimin e seancave gjyqësore, dhunës me bazë gjinore, si dhe çështjeve të tjera me të cilat përballen gratë në Kosovë. Angazhimi i më shumë të rinjve në këto përpjekje mund të ndihmojë në fuqizimin e lëvizjes feministe në Kosovë.



Forcimi i mirëkuptimit ndëretnik dhe bashkëpunimit ndërmjet individëve dhe grupeve të shoqërisë civile

Në vitin 2020, RrGK dhe anëtarët e saj kanë qenë të përfshirë në 20 nisma ndëretnike. Rrjeti u ka ofruar mundësi për bashkëpunim ndëretnik organizatave që kanë përfituar grante përmes Fondit të Grave të Kosovës në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor (BP). Në këtë bashkëpunim morën pjesë edhe përfituesit e këtyre organizatave si dhe Lobi për Barazi Gjinore në Kosovë (Lobi). RrGK ka vazhduar partneritetet e saj ndëretnike në rajon përmes Koalicionit për Adresimin e Diskriminimit me Bazë Gjinore në Punë në BP; partneritete me organizata që synojnë integrimin e perspektivës gjinore në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE); me Rrjetin Mbikëqyrës të Buxhetimit Gjinor (GBWN), një veprim i përbashkët nga organizatat partnere në Ballkanin Perëndimor dhe Republika e Moldavisë, që kërkon të institucionalizojë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor; dhe një rrjet organizatash që hulumtojnë fondet për barazinë gjinore dhe të drejtat e grave. RrGK është bërë anëtare e Shoqatave dhe të Drejtave të Grave në Zhvillim (AWID), një organizatë ndërkombëtare feministe e anëtareve e angazhuar për arritjen e barazisë gjinore dhe zhvillimit të qëndrueshëm.



Përmirësimi i kapacitetit organizativ dhe avokues të RrGK-së dhe anëtareve të saj drejt qëndrueshmërisë afatgjatë të tyre

Një lëvizje e qëndrueshme e grave nuk mund të ekzistojë pa anëtarët e saj që e mbajnë të gjallë atë. Andaj, RrGK vazhdimisht mbështet anëtarët e saj në avancimin e kapaciteteve të tyre. RrGK ka mbështetur anëtarët e saj dhe organizatat e tjera në rajon në avancimin e kapaciteteve të tyre organizative dhe të avokimit përmes mentorimit personal dhe Fondit të Grave të Kosovës.

Rrjeti ka vazhduar përdorimin e Vlerësimit të Kapaciteteve Organizative dhe Avokuese për të vlerësuar kapacitetet e organizatave anëtare, partnerëve dhe OSHC-ve nga rajoni që përfitojnë grante. Gjatë vitit 2020, RrGK ka bashkëpunuar me 53 organizata në Kosovë dhe rajonin e BP për të krijuar Plane për Zhvillimin e Kapaciteteve, të përshtatshme për çdo organizatë. RrGK pastaj i ka mbështetur këto organizata në zbatimin e planeve të tyre. Si rezultat, më shumë se 25 organizata kanë përmirësuar kapacitetet e tyre organizative dhe avokuese.

RrGK, anëtarët e saj dhe puna e tyre më e dukshme për partnerët e mundshëm, aktivistët në nivel ndërkombëtar dhe mbështetësit e mundshëm

RrGK rregullisht ka promovuar punën e anëtareve të saj në faqen e internetit të RrGK-së, në faqen e Facebook-ut, Twitter-it, Instagram-it dhe në buletin elektronik mujor Zëri i Grave Kosovare. RrGK ka rritur numrin e ndjekësve në Facebook nga 18,018 në 21,540 në vitin 2020. Në Twitter dhe Instagram, numri i ndjekësve është rritur nga 780 në 1,224, përkatësisht nga 1,279 në 2,281. Buletini



elektronik Zëri i Grave Kosovare arrin 638 persona nëpër botë. Gjatë vitit 2020, RrGK ka pasur 240 paraqitje mediale dhe ka dërguar 28 reagime/kumtesa për media, duke përfshirë:

1. [Fondi i Grave të Kosovës ndan afro 200 mijë euro për 14 organizata të rajonit](#)
2. [Fondi i Grave të Kosovës ndau 59,266€ për 20 organizata anëtare të RrGK në Kosovë](#)
3. [RrGK uron formimin e Qeverisë LVV-LDK dhe postin e gruas së parë Kryeparlamentare në Kuvendin e Kosovës](#)
4. [RrGK kujton Pagarushën si një grua të fuqishme](#)
5. [RrGK bën nderime te varri i Nexhmije Pagarushës për 17 shkurt](#)
6. [RrGK shpreh ngushëllime për vdekjen e Leze Qenës](#)
7. [RrGK shpreh pakënaqësi për mosadresimin e barazisë gjinore në Samitin e Ballkanit Perëndimor](#)
8. [RrGK shpreh shqetësim për qasjen diskriminuese ndaj grave në vendimmarrje në Kosovë](#)
9. [RrGK dhe QKSGJ dënojnë gjuhën seksiste të deputetëve të Kuvendit të Kosovës](#)
10. [RrGK propozon masat për adresimin e COVID-19 nga perspektiva gjinore: Rekomandime për Qeverinë e Kosovës](#)
11. [Pa Drejtësi nuk ka Paqe](#)
12. [RrGK bënë thirrje për përmirësim të të drejtave të punës për gratë](#)
13. [RrGK: Të ndalen sulmet ndaj Vjosa Osmanit](#)
14. [RrGK kërkon reagim nga institucionet për 20 vjeçaren nga Kosova që u gjet e përdhunuar në Kukës](#)



15. RrGK kërkon zvogëlimin e numrit të zëvendësministrave dhe zbatimin e LBGj-së
16. RrGK dënon sjelljet ndaj kryeparlamentares Osmani
17. RrGK kërkon drejtësi të pakompromis për vrasjen e gruas nga bashkëshorti në Kamenicë
18. Drejtësia në gjumë, gratë po vazhdojnë të përjetojnë dhunë
19. RrGK dënon uljen e dënimit për Pjetër Ndrecajn
20. Buxheti i përgjegjshëm gjinor: Përmbledhje e arritjeve dhe e ardhmja
21. 20 vite të Rezolutës I 325: Kosova duhet ta prioritzojë zbatimin e kësaj Rezolute
22. RrGK kërkon integrimin e perspektivës gjinore në tekstet e reja shkollore
23. Letër Publike për Kryetarin e Skenderajt: Zero tolerancë për gjuhën denigruese ndaj grave
24. RrGK i dërgon letër Kryeministrit Hoti për shkarkimin e Selmanajt
25. RrGK kërkon përgjegjësi institucionale për rastin e incestit në Mitrovicë
26. RrGK në përkrahje të grave të Krushës, kërkon drejtësi për krimet e luftës
27. RrGK: Duhet ta luftojmë mendësinë që ende e portretizon gruan brenda një konstrukti shoqëror
28. RrGK mbajti Kuvendin e 18-të Vjetor të Anëtareve

Më shumë anëtare kërkojnë fonde, planifikojnë në mënyrë efektive, udhëheqin organizata dhe ndërmarrin iniciativa efektive avokuese

Grantet e Fondit të Grave të Kosovës për anëtarët e RrGK-së

Përmes Fondit të Grave të Kosovës (FGK), RrGK ka ndarë 19 grante për 20 organizata përfituese në Kosovë që arrinin në 59,266 € në vitin 2020.

Grantet u mbështetën nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) (48,410 €) dhe UN Women (10,866 €). Grantet në Partneritetit për Ndryshim m kanë ndikuar në rritjen e bashkëpunimit midis organizatave anëtare, duke u mundësuar organizatave të rajoneve të ndryshme të Kosovës të bashkojnë forcat dhe të avokojnë së bashku. Për shembull, Medica Kosova & Djepi i Buzëqeshjes filluan iniciativën: “Mobilizimi i grave anëtare të asamblesë për të adresuar nevojat e grave të traumatizuara nga lufta”.

Përveç kësaj iniciative të partneritetit, iniciativa të tjera të mbështetura nga RrGK në vitin 2020 kanë përfshirë:



RrGK organizon Sesionin e Orientimit me 20 organizata përfituese të FGK në janar 2020.



- Gratë EcoKos me iniciativën: “Avokim për qasje më të lehtë të grave në grante në komunën e Prishtinës” (€3,649, me përkrahjen e ADA dhe UNW);
- Organizata e Personave me Aftësi të Kufizuara, Handikos Prishtina me iniciativën: “Integrimi i grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në shoqëri” (€2,470, me përkrahjen e ADA dhe UNW);
- Shoqata e Grave Aureola me iniciativën: “Avancimi i ligjit të trashëgimisë” (€2,300, me përkrahjen e ADA dhe UNW);
- Shoqata e Grave të Pensionuara “Vita-Jeta” me iniciativën: “Diabeti te të Moshuarit” (€2,030, me përkrahjen e ADA dhe UNW);
- Shoqata e Grave Bletare “Okarina e Runikut” me iniciativën: “Promovimi i Punësimit për Përfituesit e Skemës së Ndihmës Sociale në Rajonin e Drenicës” (€3,110, me përkrahjen e ADA dhe UNW);
- Komiteti i Grave të Verbra të Kosovës me iniciativën: “Respektimi i të drejtave të grave të verbra dhe me shikim të dëmtuar të garantuar me ligj” (€2,832, me përkrahjen e ADA dhe UNW);
- Shoqata e Mamive të Kosovës me iniciativën: “Promovimi i shëndetit të nënës dhe fëmijës përmes forcimit të rolit të mamisë” (€3,242, me përkrahjen e ADA dhe UNW);
- Psikoterapistët në Veprim me iniciativën: “Shëndeti dhe trajtimi i sëmundjeve të heshtura te gratë e moshës së tretë” (€3,537, me përkrahjen e ADA dhe UNW);
- Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve me iniciativën: “Fuqizimi i grave viktime të dhunës me bazë gjinore përmes programeve të riintegritit” (€3,355, me përkrahjen e ADA dhe UNW);

- Shoqata e Grave me iniciativën “Fuqizimi i Grave në Tregun e Punës” (€3,105, me përkrahjen e ADA dhe UNW);
- Nisma e Pavarur e Personave të Verbër: “Unë dua të bëj një jetë dinjitoze” (€2,955, me përkrahjen e ADA dhe UNW);
- Qendra për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës Raba Voca me iniciativën: “Thyeni heshtjen” (€3,351, me përkrahjen e ADA dhe UNW);
- Shoqata e të Verbërve dhe Personave me Shikim të Dëmtuar me iniciativën: “Mbështetja e të Verbërve dhe Personave me Shikim të Dëmtuar për të bërë një jetë të pavarur” (€2,982, me përkrahjen e ADA dhe UNW);
- Shoqata e Grave Fermere “Krusha e Vogël” me iniciativën: “Edukimi Shëndetësor i Grave në Zonat Rurale” (€3,195, me përkrahjen e ADA dhe UNW);
- OJQ Drugëza me iniciativën: “Avancimi i të drejtave të grave në pronë dhe fuqizimi i tyre ekonomik” (€2,136, me përkrahjen e UNW);
- OJQ Gruaja Hyjnore me iniciativën: “Rritja e ndërgjegjësimit të vajzave dhe grave për shëndetin riprodhues” (€2,995, me përkrahjen e UNW);
- Qendra Rinore Lipjan me iniciativën: “Mbështetja e vajzave dhe grave për pjesëmarrje aktive në ekonomi” (€2,940, me përkrahjen e UNW);



- Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara në Mitrovicë - Handikos Mitrovica me iniciativën: “Përmirësimi i aftësive të punësimit të rinjtë, vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara” (€2,785, me përkrahjen e UNW);
- Medica Kosova & Djepi i Buzëqeshjes me iniciativën: “Mobilizimi i grave anëtare të asamblesë për të adresuar nevojat e grave të traumatizuara nga lufta” (€6,295, me përkrahjen e ADA dhe UNW).

Që nga vjeshta 2012, përfituesit e FGK ndërmorën 511 iniciativa avokimi me mbështetjen e FGK, dhe 24,387 persona kanë përfituar nga iniciativat e anëtareve të RrGK. Në vitin 2020, anëtarët e stafit të RrGK ofruan rreth 2000 seanca mentorimi përmes e-mailit, telefonit dhe disa takimeve individuale për përfituesit e granteve të FGK. Komiteti i Shqyrtimit të Grantit gjithashtu kontribuoi në avancimin e kapaciteteve të anëtareve duke shqyrtuar çdo aplikim dhe duke ofruar këshilla praktike për paraqitjet në të ardhmen. Kjo do t'i ndihmojë anëtarët e RrGK të përgatisin aplikime më të mira për FGK dhe donatorë të tjerë në të ardhmen. Shtojca 1a. përmban një listë të të gjitha granteve të dhëna nga FGK për anëtarët e RrGK në vitin 2020 dhe rezultatet e tyre të pritshme.

Fondi i Grave të Kosovës Zgjeron Dhënien e Granteve në BP

RrGK dhe partnerët e tij në Koalicionin e Organizatave për të Drejtat e Grave kundër Diskriminimit në BP kanë dhënë 14 grante për organizatat e shoqërisë civile (OSHC) në rajon përmes FGK. Nga këto, gjashtë grante (një për secilin vend të BP) kanë mbështetur OShC-të të përqendruara në sigurimin e

ndihmës juridike dhe monitorimin e gjykatave. Dy grante (një në Serbi dhe Shqipëri) financojnë avokimin e OShC-ve për ndryshime ligjore dhe politike dhe/ose përgjigje të përmirësuar institucionale. Në fund, gjashtë grante (një për secilin vend të BP) u janë ndarë OShC-ve të përqendruara në zhvillimin e ndërgjegjësimit dhe fuqizimit të grave për të raportuar diskriminimin. Në total, grantet, në vlerë prej 215,319€, janë pjesë e një iniciative të përbashkët, “Përparimi i të Drejtave të Punës së Grave”, financuar nga BE dhe bashkë-financuar nga Agjencioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar. OShC-të e mëposhtme morën mbështetje përmes këtij veprimi:

Shqipëri

- Rrjeti i Fuqizimit të Grave Shqiptare në Tiranë: “Përmirësimi i të Drejtave të Grave në Punë përmes Përmirësimit të Qasjes në Drejtësi”,
- Qendra e Zhvillimit të Komunitetit Sot për të Ardhmen: “Avokimi për përmirësimin e reagimit institucional ndaj diskriminimit gjinor në punë duke ndarë praktikat në Bashkinë e Lezhës dhe krijimi i ndërveprimeve me komitetin për mbrojtjen nga diskriminimi në punë”, dhe
- Linja e këshillimit për vajzat dhe gratë: “Fuqizimi i grave dhe vajzave për të raportuar diskriminimin në bazë gjinore”.

Bosnjë dhe Hercegovinë

- Fondacioni i Rrjetit të Grave të Bashkuara: “Përmirësimi i pozitës së grave në punësim dhe parandalimi i diskriminimit me bazë gjinore në Bosnjë dhe Hercegovinë”, dhe



- Akademia e Fondacionit për Gratë: “Edhe ky është diskriminim”.

Kosovë

- Instituti i Kosovës për Drejtësi: “Përmirësimi i të Drejtave të Grave në Punë”, dhe
- Qendra e Kosovës për Studime Gjinore: “Parandalimi i të gjitha formave të diskriminimit në vendin e punës”.

Maqedoni e Veriut

- Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut: “Gratë punëtore bashkohen”, dhe
- Shoqata Punëtoret e Zëshme të Tekstilit: “Promovimi i të Drejtave të Punëtoreve të Tekstilit”.

Mal i Zi

- Sindikata e Mediave të Malit të Zi: “Barazia përmes Drejtësisë: Rastet e Diskriminimit në Punë”, dhe
- Shoqata e të Rinjve me Aftësi të Kufizuara: “Të fuqizuar, të punësuar, të përfshirë”.

Serbi

- Shoqata e Viktimologjisë së Serbisë: “Njihni Diskriminimin Gjinor, Identifikoni Shkeljet e Ligjit të Punës dhe Punësimit! Reagoni!”.



- Iniciativa A II - për të Drejtat Ekonomike dhe Sociale: “Përmirësimi i Praktikave Institucionale në Parandalimin e Diskriminimit ndaj Grave në Tregun e Punës në Serbi”, dhe
- Shoqata ROZA për të Drejtat e Punës së Grave: “Çfarë më pret në tregun e punës”.

Shtojca Ib përmban një listë të të gjitha granteve të dhëna nga FGK për OSHC-të në BP në vitin 2020 dhe rezultatet e tyre të pritshme.

Ngritën kapacitetet e stafit të RrGK

RrGK ka vazhduar që të ofrojë mundësi për ngritje të kapaciteteve për stafin, duke përfshirë ato që ndërliiden me komunikim ndërmjet zyrave, integrimin e perspektivës gjinore, sigurinë digjitale dhe financat. Monitorim i punës u ofrua në çështjet e lidhura me avokimin të Bashkimi Evropian (BE); kryerjen e analizave gjinore, shkrimin e koncept-dokumente; hartimin e strategjive avokuese; hartimin e raporteve; monitorimin dhe vlerësimin; hulumtimin si dhe aftësitë e të shprehurit në publik. Më tej, RrGK në partneritet me Shoqatën Evropiane të Grave

“Me punëtori të tilla, organizatat e shoqërisë civile të grave mund të mësohen të ndërtojnë kapacitetet e tyre dhe do të jenë në gjendje të ngritin shumë tema të barazisë gjinore përmes rekrutimit të vullnetarëve.”

Etleva Malushaj, Koordinatore e Projektit të RrGK-së, e cila mori pjesë në punëtorinë “Vullnetarizmi në Kosovë”, organizuar nga organizata Lens.



Avokate (EWLA) organizoi disa punëtori për anëtarët e stafit në tema të tilla si: Acquis e BE-së për Barazinë Gjinore, Ngacmimin Seksual dhe Diskriminimin.

Përmirësimi i klimës së financimit për organizatat për të drejtat e grave

Sado që disa iniciativa avokuese mund të ndërmerren në baza vullnetare, organizatat për të drejtat e grave (OSHCG-të) ende kanë nevojë për burime për të përkrahur shumë aspekte të punës së tyre të rëndësishme. Aktivizmi i qëndrueshëm për të drejtat e grave kërkon mbështetje, andaj RrGK vazhdoi përpjekjet e saj në drejtim të mobilizimit të burimeve të mjaftueshme nga akterët vendorë dhe ndërkombëtarë për mbështetjen e lëvizjes së grave në Kosovë dhe në rajon. Në vitin 2020, RrGK takoi disa financues si dhe dërgoi përmbledhje të politikave për t'i vetëdijesuar ata lidhur me nevojat financiare të OSHCG-ve. Pas avokimit, RrGK kontribuoi në sigurimin e burimeve shtesë për OSHCG-të në Kosovë dhe rajon.

Përmirësimi i zbatimit të Strategjisë së RrGK-së për Ngritje të Fondeve

RrGK është duke e finalizuar Strategjinë e Filantropisë, e cila do të identifikojë forma inovative dhe alternative të mbledhjes së fondeve, përveç fondeve ndërkombëtare, të cilat mund të mbështesin RrGK-në dhe anëtarët e saj në planin afatgjatë. RrGK ka hulumtuar opsione të ndryshme filantropie që ekzistojnë në të gjithë botën, veçanërisht në kontekste të ngjashme si Kosova. Rrjeti gjithashtu ka hulumtuar ato që janë përdorur në Kosovë për të informuar Strategjinë e Filantropisë.

Disa hapa janë ndërmarrë gjithashtu për të përmirësuar faqen e internetit të RrGK-së për të mbështetur më mirë mbledhjen e fondeve në internet. Kjo përfshin një seksion të ri me materiale promovuese të RrGK-së, si tasa, maica, bluza dhe fletore. Të gjitha veshjet kanë mesazhe frymëzuese feministe ose logon e RrGK-së. Përmes këtyre materialeve, individët mund të bëhen mbështetës të misionit të RrGK-së dhe të kontribuojnë në ngritjen e vetëdijes për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore.

Donacionet e pranuar për këta artikuj kontribuojnë në Fondin e Qëndrueshëm të RrGK-së, i cili ndihmon në mbulimin e kostove thelbësore dhe mbështetjen e programeve të rëndësishme. Sa i përket rezultateve, RrGK ka rritur kursimet në Fondin e saj të Qëndrueshmërisë nga 3,263€ në vitin 2018 deri në 11,973€ në vitin 2020.



Mallrat e RrGK - Tas dhe bluzë "Super grua" në dispozicion me donacione.



Përmirësimi i njohurive dhe mirëkuptimit midis organeve përkatëse të BE-së dhe donatorëve të tjerë në lidhje me llojet e mbështetjes që u nevojiten OSHCG-ve të ndryshme

Këtë vit RrGK ka publikuar hulumtimin historike, *Ku janë paratë për të drejtat e grave?*, i cili shqyrton trendët e financimit në BP në mbështetje të OSHCG-ve. Kryer në bashkëpunim të ngushtë me partnerët e OSHCG në rajon dhe mbështetur nga Fondacioni Kvinna till Kvinna, raporti i hulumtimit u lansua në BE në Bruksel, në Sida në Suedi dhe në të gjashtë vendet e BP me pjesëmarrje nga më shumë se 300 njerëz nga OSHCG, BE, Sida, zyrtarë përkatës qeveritarë dhe financues të tjerë. Ngjarjet e lansimit nxitën diskutime midis financuesve dhe OSHCG-ve lidhur me nevojat e fondeve të OSHCG, duke u bazuar në rekomandimet e raportit. Disa takime plotësuese shtesë janë organizuar midis financuesve dhe OSHCG-ve për të hyrë më thellë në bashkëpunim drejt realizimit të rekomandimeve për nevojat e fondeve të OSHCG-ve.

Përveç kësaj, RrGK shkroi dy përmbledhje të politikave këtë vit me rekomandime për të informuar Planin e Veprimit Gjinnor të BE-së III, Instrumentin e BE-së për Para-Anëtarësimin III dhe rregulloren e re që do të zëvendësojë Instrumentin e Fqinjësisë, Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të BE-së (NDICI) mbi Financimin e jashtëm të BE-së. RrGK u dërgoi këto përmbledhje disa akterëve në BE, si dhe palëve të tjera të interesuara, drejt ngritjes së vetëdijes se si këto instrumente mund të kontribuojnë më mirë në barazinë gjinore dhe të përmbushin nevojat e OSHCG-ve. RrGK gjithashtu avokoi për rekomandimet gjatë takimeve të avokimit me zyrtarë të ndryshëm të BE-së.

***Përmirësimi i vetëdijesimit institucional dhe publik për rëndësinë e zbritjeve
tatimore për të mbështetur punën e rëndësishme të grupeve të të drejtave të grave***

Raporti i lartpërmendur, *Ku janë paratë për të drejtat e grave*, përfshin rekomandime për përmirësimin e sistemit aktual të tatimeve, në mënyrë që të krijojë një mjedis të përmirësuar të mundshëm për individët dhe bizneset për të bërë donacione që mbështesin shoqërinë civile, përfshirë grupet e të drejtave të grave. Këto u diskutuan shkurtimisht me zyrtarët publikë gjatë ngjarjeve të lansimit.



Gratë në Politikë dhe Vendimmarrje

Qëllimi afatgjatë i këtij programi është që gratë të marrin pjesë në mënyrë aktive në politikë dhe vendimmarrje, në nivelin lokal dhe atë qendror. RrGK ka shënuar përparim drejt përmbushjes së këtij qëllimi. Për shembull, avokimi i RrGK, ndër të tjera, kontribuoi në zgjedhjen e më shumë grave në pozitat e vendimmarrjes. Për herë të parë, një grua u zgjodh kryetare e Parlamentit të Kosovës.

Më tej, qeveria aktuale e Kosovës ka emëruar një grua si nënkryeministre dhe nga 16 ministri, 3 prej tyre drejtohen nga gra, një rritje prej 4.8% në zgjedhjet e fundit deri në 18.75% në vitin 2020. Një indikator tjetër i pjesëmarrjes së përmirësuar të grave në politikë dhe vendimmarrje në vitin 2020 ishin 11 politikat e ndryshuara për të paraqitur më mirë prioritetet e grave, integrimin e perspektivës gjinore ose përputhshmërinë me Ligjin për Barazi Gjinore. Që kur RrGK filloi që ti gjurmojë këto informata, Rrjeti, anëtarët e saj si dhe Lobi për Barazi Gjinore kanë arritur që suksesshëm të avokojnë për ndryshimin e 162 politikave për përmirësimin e jetës së grave dhe vajzave, në nivel lokal dhe qendror.

Rritet dhe përmirësohet pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendimmarrje në nivel lokal dhe qendror sipas Ligjit për Barazi Gjinore (50%)

Përmes FGK, anëtarët e RrGK-së rritën numrin e grave me prejardhje të ndryshme që morën pjesë në politikë dhe procese vendimmarrëse nga 2,035 në vitin 2019 deri në 2,076 në vitin 2020. Kjo përfshinte 58 gra serbe, 37 gra me aftësi të ndryshme dhe 194 gra nga zonat rurale. RrGK gjithashtu vazhdoi bashkëpunimin e saj me Organizatën e Personave me Distrofi Muskulare dhe Ruka Ruci posaçërisht në drejtim të rritjes së angazhimit politik të afërsisht 27 grave me aftësi të ndryshme dhe 21 grave nga

komuniteti serb në proceset e vendimmarrjes, të mbështetura nga BE. Një përshkrim më i hollësishëm i progresit të bërë drejt këtij objekti mund të gjendet në seksionin tjetër.

Koalicioni për Barazi funksional në nivelin lokal dhe qendror Lobi për Barazi Gjimore në Kosovë funksional në të gjitha komunat

Koalicioni për Barazi u krijua në 22 qershor 2018. Përbëhet nga gratë në politikë në nivelin qendror dhe lokal, si dhe OShC-të e drejtuara nga gratë. Koalicioni kërkon të mbështesë dhe fuqizojë anëtarët e tij për të përmirësuar pozitat e grave në politikë dhe vendimmarrje dhe për të promovuar avancimin e barazisë gjimore në Kosovë. Pjesëmarrëset u zotuan se do të punojnë drejt përmbushjes së këtij misioni të përbashkët, pa marrë parasysh preferencat e tyre politike, gjininë, moshën, etnicitetin, aftësinë, religjionin, pozitën gjeografike, nivelin e edukimit ose statusin shoqëror-ekonomik.



Lobi i Kosovës për Barazi Gjinore në Kosovë (këtu e tutje, Lobi) është themeluar në vitin 2014. Ai bashkon gratë politike dhe gratë në shoqërinë civile për të avokuar në nivel lokal dhe qendror për avancimin drejt barazisë gjinore dhe ka vazhduar funksionimin në 27 komuna. Numri i grave të angazhuara në Lob në vitin 2020 ishte 512. Së bashku, grupet e Lobit ndërmorën 43 iniciativa avokimi dhe kontribuan në 11 ndryshime të politikave këtë vit. Më 4 nëntor, për shkak të pandemisë, Koalicioni për Barazi dhe Lobi i Kosovës për Barazi Gjinore mbajtën një takim të përbashkët me anëtarët e RrGK-së, anëtarët e komunës dhe mbështetës të tjerë përmes platformës Zoom, për të diskutuar “Gratë në vendimmarrje në nivelin lokal”. Gjatë këtij takimi, pjesëmarrësit ndanë përvojat e tyre dhe diskutuan mundësitë e avokimit për të rritur pjesëmarrjen e grave dhe grave të reja në vendimmarrje në nivelin lokal dhe rëndësinë e zbatimit të Ligjit për Barazinë Gjinore (LBGj).

“Të gjitha objektivat duhet të arrihen brenda kornizës së trajtimit të barabartë, duke siguruar përfaqësim të barabartë për burrat dhe gratë. Gratë në përgjithësi e kanë më të vështirë dhe përballen me pengesa në udhëtimin e tyre; megjithatë, unë inkurajoj të gjitha gratë të mos dorëzohen.”

Selvie Rexhepi, Nënkyetare e Komunës për Komunitete në Komunën e Klllokotit

Zhvillimi i kapaciteteve të grave në politikë për të avokuar për prioritetet e grave

Takimi i lartpërmendur, i kombinuar me punëtoritë e mbajtura gjatë vitit, zhvilluan më tej kapacitetet e grave në politikë për të avokuar për prioritetet e grave duke ofruar shembuj të praktikave më të mira dhe duke i përmirësuar aftësitë e tyre avokuese. Drejtorja Ekzekutive e RrGK-së, Igballë Rogova, ka vazhduar të ofrojë seanca të mentorimit për anëtarët dhe grupet e Lobit nëpër Kosovë, përmes 1,958 thirrjeve telefonike, e-mailit ose vizitave nëpër komunat e tyre këtë vit. Këto seanca shërbyen për të fuqizuar anëtarët e Lobit në avokimin e tyre për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore. RrGK nuk i sheh apo trajton anëtarët e Lobit si anëtare të partive politike, por më tepër si udhëheqëse në komunat e tyre. Drejtorja Ekzekutive e RrGK-së gjithashtu promovoi nismat e tyre, mbështeti ato në avokim dhe i ndihmoi në tejkalimin e sfidave gjatë avokimeve të tyre drejt barazisë gjinore.



Përfaqësuesit e RrGK-së takohen me Kryeministrin e atëhershëm të Kosovës, Albin Kurti, në shkurt 2020.

Rritja e vetëdijesimit për rëndësinë e harmonizimit të LBGj me ligjet e tjera relevante

RrGK-ja vazhdoi avokimin për zbatimin e LBGj. Më 26 shkurt, Drejtorja Ekzekutive e RrGK, Igballë Rogova, u takua me Kryeministrin e atëhershëm të Kosovës, Albin Kurti. Rogova shprehu zhgënjimin për mungesën e zbatimit të LBGj në lidhje me përfaqësimin e grave në pozitat vendimmarrëse në qeverinë e re, megjithëse kjo qeveri kishte më shumë gra në pozitat e vendimmarrjes sesa ato të mëparshmet. RrGK theksoi rëndësinë e vazhdimin të bashkëpunimit të suksesshëm midis RrGK-së dhe Agjencisë për Barazi Gjinore (ABGJ), duke theksuar që ABGJ-ja është një mekanizëm jashtëzakonisht i rëndësishëm për monitorimin e zbatimit të LBGj-së. Gjatë komentimit mbi dokumente të ndryshme të politikave, RrGK-ja gjithashtu ka ngritur vazhdimisht rëndësinë e harmonizimit të ligjeve zgjedhore me LBGj, duke siguruar pjesëmarrjen e 50% të grave në asamblatë komunale dhe atë nacionale.

Komunikimi dhe bashkëpunimi i shtuar mes grave në politikë, organizatave të grave dhe grave votuese për çështjet që ato i konsiderojnë prioritete

Gratë në politikë, organizatat e drejtuara nga gratë dhe gratë votuese komunikuan dhe bashkëpunuan më shumë për çështje që gratë i konsiderojnë me prioritet me mbështetjen nga Koalicioni për Barazi, Lobi, RrGK, anëtarët e saj dhe gratë në politikë. Për shembull, anëtarët e Lobit avokuan për çështje që gratë i konsiderojnë me prioritet në bashkëpunim të ngushtë me votuesit nga komunat e tyre. Këtë vit, Lobi mbajti 35 takime me gra politike, votuese dhe OJQ. Një listë e iniciativave të tyre është në Shtojcën 2.



Gjatë këtij viti, përmes iniciativave të përkrahura nga FGK, organizatat anëtare të RrGK organizuan pesë takime me gratë në politikë për çështjet që ato i konsiderojnë prioritete. Lista me iniciativat e tyre është në Shtojcën Ia.

Në kontekstin e dialogut të vazhdueshëm midis Kosovës dhe Serbisë, RrGK organizoi disa diskutime me gratë e reja mbi rolin e tyre në paqen dhe proceset e sigurisë. Midis këtyre diskutimeve kishte dy punëtori me gra të reja nga Gjakova dhe Deçani. Për shkak të pandemisë, punëtoritë u zhvilluan në internet. Këto punëtori u mundësuan grave të reja të thellojnë njohuritë e tyre mbi ndërtimin e paqes, Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (UNSCR) 1325 mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë, dhe aktivitetet e grave aktiviste dhe OSHCG-ve në Kosovë për rritjen e numrit të grave në vendimmarrje. Nikoqire e punëtorive ishte Igballe Rogova, Drejtore Ekzekutive e RrGK-së, e cila ndau përvojën e saj dhe të RrGK-së në avokimin për zbatimin e RKSKB 1325 në Kosovë. Bazuar në hulumtimin e kryer me gra të ndryshme, përfshirë gratë e reja, të mbështetur nga UN Women, RrGK gjithashtu identifikoi çështjet prioritare që gratë e ndryshme votuese do të dëshironin të shihnin të diskutoheshin në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.



Avokimi i iniciuar për çështjet që gratë i konsiderojnë prioritet

Më 14 shkurt, Drejtorja Ekzekutive e RrGK-së, Igballe Rogova, u takua me kryetaren e Parlamentit Vjosa Osmani. Rogova deklaroi se në kontekstin e Dialogut Kosovë-Serbi, është e rëndësishme të themelohet një komitet këshillimor i përbërë nga aktivistë të të drejtave të grave. Ky komitet duhet të themelohet në të dy vendet respektivisht. Sipas Rogovës, aktivistët e të dy vendeve kanë shumë për të kontribuar në këtë proces. Kjo kërkesë është bërë bazuar në RKSKB

1325. Osmani shprehu vlerësimin e lartë për angazhimin e RrGK-së për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave. Çështjet që gratë identifikuan si prioritet për Dialogun iu dërguan zyrtarëve të Kosovës dhe BE-së, si dhe u ndanë me media.

RrGK ka vazhduar punën dhe përpjekjet për të rritur pjesëmarrjen e grave në dialogun Kosovë-Serbi. Këtë vit, RrGK ishte pjesë e disa takimeve me OSHC të tjera të cilat arritën kulmin në krijimin e një Platforme të Shoqërisë Civile për Dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në shtator. U zhvilluan disa takime koordinuese me prani nga stafi i RrGK-së. Një nga ngjarjet kryesore ishte një



Përfaqësuesit e RrGK takohen me gruan e parë që shërben si Kryetare e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, në shkurt 2020.

takim midis OShC-ve dhe Kryeministrit Avdullah Hoti, ku RrGK dhe organizatat e saj anëtare ngritën çështjen e zbatimit të RKS KB 1325 në Dialog.

Këtë vit, si pjesë e hulumtimit të titulluar *Ku është vendi im në tryezë? Kontributet dhe pritjet e grave nga proceset e ndërtimit të paqes në Kosovë*, RrGK në bashkëpunim me tri organizata anëtare, zhvilluan 79 intervista të shkurtra me gra dhe gra të ndryshme të grupeve të ndryshme etnike në Kosovë. Këto intervista të shkurtra identifikuan nevojat dhe përparësitë e tyre në Dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, gjë që kontribuoi në avokimin që pasoi (shih më poshtë). Raporti i hulumtimit pritet të publikohet në fillim të vitit 2021. Gjetjet do të vazhdojnë të shërbejnë si një mjet për avokim në të ardhmen për rritjen e mëtejshme të pjesëmarrjes së grave dhe grave të reja në proceset e paqes dhe sigurisë.

Që nga viti 2005, RrGK ka monitoruar zbatimin e RKS KB 1325 mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë në Kosovë. Në gusht, RrGK filloi punën në edicionin e dytë të *1325 Fakte dhe Përralla*, një koleksion historik dhe të dhënash për të identifikuar se si është zbatuar Rezoluta 1325 në Kosovë në 10 vitet e fundit. Ky botim pritet të botohet në fillim të vitit të ardhshëm.

Më 30 tetor, në prag të 20 vjetorit të Rezolutës 1325 të KB për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, RrGK kërkoi që Qeveria e Kosovës të sigurojë pjesëmarrje kuptimplotë të grave në negociata, paqe dhe procese të sigurisë, siç garantohet nga kjo Rezolutë. Në këtë letër, RrGK renditi nevojat dhe prioritetet e grave të ndryshme të grupeve të ndryshme etnike në Kosovë drejt Dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke kërkuar që Qeveria t'i adresojë këto çështje.

Më 31 tetor, RrGK si një grup kryesor i të drejtave të grave në Kosovë, i dërgoi një letër përfaqësuesit special të BE-së për Dialogun Beograd-Prishtinë, Miroslav Lajçak. Përmes kësaj letre



zyrtare, RrGK shprehu shqetësim të thellë se OSHCG-të nuk ishin ftuar në një konsultë të fundit që ai mbajti me shoqërinë civile në Kosovë në lidhje me Dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. RrGK nënvizoi se BE, sipas RKS KB 1325 dhe Qasjes Strategjike të BE ndaj Grave, Paqes dhe Sigurisë, ka përgjegjësinë të sigurojë që gratë të jenë pjesë e proceseve të paqes. RrGK gjithashtu kërkoi që nevojat dhe prioritetet e grave në lidhje me Dialogun, të identifikoheshin në hulumtimin e sipërpërmendur, të përfaqësohen në agjendë dhe të adresohen në Dialogun në vazhdim me Serbinë.

RrGK gjithashtu ka mbështetur dhe fuqizuar gratë për të identifikuar dhe avokuar për prioritetet e tyre. Kjo u arrit përmes granteve për anëtarët e RrGK-së për iniciativat e tyre të avokimit përmes FGK. Fondi ka mbështetur përpjekjet e anëtareve për të monitoruar dhe mbrojtur zbatimin e ligjeve dhe politikave ekzistuese. Këtë vit, FGK dhe Lobi ndërmorën 92 iniciativa avokimi për çështje që gratë i konsiderojnë me prioritet.

Përmirësohet institucionalizimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Kosovë

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor (BPGj) siguron shpërndarje dhe shpenzim të barabartë, efikas dhe transparent të fondeve publike. RrGK ka punuar dhe avokuar për institucionalizimin e BPGj në Kosovë që nga viti 2011. Në vitin 2020, RrGK vlerësoi aplikimet e organizatave dhe grupeve studimore që aplikojnë për kapacitete dhe njohuri të zgjeruara në BPGj dhe ftoi 11 organizata të marrin pjesë në trajnime për BPGj të avancuar; BPGj dhe prokurimi publik; dhe BPGj hyrëse, si pjesë e veprimit të përbashkët të Rrjetit Mbikëqyrës të Buxhetit Gjinor (GBWN). Më parë, RrGK organizoi një trajnim të brendshëm në shkurt për të siguruar që të gjitha organizatat të janë të njohura me konceptet e BPGj,

kornizën ligjore përkatëse të Kosovës dhe kontekstin në lidhje me BPGj. Këto organizata përfshijnë: Shoqata e Grave Aureola, Organizata për Reformën Lokale (EULOC), Shoqata e Grave të Mitrovicës për të Drejtat e Njeriut, Undruženje Poslovnih Žena WBA, Instituti GAP, Demokracia për Zhvillim, Shoqata e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Ruka Ruci, Nas Dom, Iniciativa e Grave të Kosovës dhe Gratë EcoKos. Në trajnimet në internet, RrGK dha dy module, përkatësisht, për Analizën e Shpenzimeve të Buxhetit dhe Strategjitë e Lobimit dhe Avokimit. Këto aktivitete kontribuan në ndërtimin e kapaciteteve të OSHC-ve për BPGj-në. Për më tepër, OShC-të nga rajoni tani janë të lidhura përmes GBWN.

Në mars, gjatë përhapjes së pandemisë COVID-19, RrGK hartoi një [përmbledhje të politikave](#) mbi masat për të adresuar COVID-19 nga perspektiva gjinore. Kjo përmbledhje e politikave përfshiu 16 rekomandime për qeverinë, drejt masave më të përgjegjshme gjinore.

Kjo i parapriu hulumtimit të kryer nga korriku deri në tetor, i titulluar [“Pandemia nuk njeh gjini”?](#) Një *Analizë Buxhetore Fiskale Gjinore: Përgjigja e Qeverisë së Kosovës ndaj Pandemisë COVID-19 nga Perspektiva Gjinore*, i cili u publikua me 23 dhjetor. Metodologjia përfshinte metoda të përziera: një rishikim i të gjitha hulumtimeve mbi pandeminë, vendimet e qeverisë dhe dokumentet përkatëse të buxhetit; intervista me zyrtarë në ministri dhe komuna; si dhe një anketë me OShC-të për të vlerësuar përfshirjen e tyre në reagimin ndaj krizës, në të cilën morën pjesë 75 OSHC. Ky raport përfshinë 50 rekomandime për Qeverinë, Zyrën Kombëtare të Auditimit, komunat, Kuvendin e Kosovës, BE-në dhe financuesit e tjerë dhe shoqërinë civile. Gjatë publikimit të raportit, akterë të ndryshë të pranishëm nga



Qeveria, Kuvendi i Kosovës dhe Shoqëria Civile, reflektuan mbi gjetjet dhe rekomandimet e dala nga raporti.

Në nëntor, RrGK publikoi përmbledhjen e politikave të saj për Monitorimin e zbatimit të indikatorit 5.c.1 të Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (KB) SDG “proporcioni i vendeve me sisteme për të ndjekur dhe bërë alokime publike për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave”, dhe bëri ekzaminimin e progresit të Qeverisë së Kosovës drejt zbatimit të tij. Kjo përmbledhje e politikave përfshiu 11 rekomandime për institucione të ndryshme, me përgjegjësi që lidhen me LBGj.

Në dhjetor, RrGK mbajti një seancë orientuese me gjashtë organizata nga Kosova që kanë përfituar grante për LBGj, si pjesë e GBWN. Këto organizata përfshijnë: EULOC, Undruženje Poslovnih Žena WBA, Shoqata e Grave të Mitrovicës për të Drejtat e Njeriut, Shoqata e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Nisma për Gratë e Kosovës dhe Gratë EcoKos. Projektet e tyre përfshijnë, përkatësisht: “Monitorimi dhe mentorimi i zbatimit të duhur të politikave gjinore në Komunën e Vitisë”; “Fuqizimi i grave përmes analizës së politikave lokale dhe pjesëmarrjes në buxhetimin gjinor në



RrGK mban një takim orientues me të drejtat e grave dhe OSHC-të e tjera përfituese të granteve të LBGj në dhjetor 2020.

veri të Kosovës”; “Perspektiva gjinore për planifikim të qëndrueshëm ekonomik”; “Monitorimi dhe analizimi në hartimin e politikave lokale nga perspektiva gjinore”; “Buxhetimi gjinor drejt zhvillimit ekonomik të ekuilibruar gjinor”; dhe “Menaxhimi i higjienës menstruale, jeta e pastër për gratë dhe vajzat”. RrGK do të mbështesë OSHC-të me iniciativat e tyre në vitin e ardhshëm.

Rekomandime konkrete për përmirësimin e buxhetimit gjinor të paraqitura para zyrtarëve

RrGK mbajti një takim avokimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit, duke diskutuar rekomandimet për këtë institucion dhe si të sigurohet përparim i mëtejshëm në zbatimin e Indiktorit të KB-së SDG 5.c.1. Në këtë takim, Zyra Kombëtare e Auditimit deklaroi se ata ishin të interesuar të përfshinin një perspektivë gjinore gjatë auditimit të buxhetit dhe se ata do të sigurojnë bashkëpunimin midis RrGK-së dhe departamentit të auditimit të performancës brenda institucionit. RrGK do të ketë më shumë takime avokimi me institucionet përkatëse për të diskutuar rekomandimet specifike që rezultojnë nga kjo përmbledhje e politikave në vitin 2021.

Përmirësimi dhe rritja e pjesëmarrjes së OSHCG-ve në procesin e anëtarësimit në BE

RrGK ka kontribuar rregullisht në përfshirjen e organizatave anëtare dhe grave politike në procesin e anëtarësimit në BE. Aktivistët dhe organizatat për të drejtat e grave u inkurajuan dhe u ndihmuan në mënyrë specifike për të dhënë kontribut në Raportin e Progresit të këtij viti për vitin 2020. Pjesa më e



madhe e këtij kontributi të përbashkët u pasqyrua në raportin e këtij viti. RrGK gjithashtu ndihmoi shumë organizata të grave, lokale dhe rajonale, për të ofruar rekomandimet e tyre për procesin e konsultimit të TACSO për IPA III. Më saktësisht, shtatë OSHCG morën pjesë në këto procese.

OSHCG-të dhe gratë janë më të informuara rreth proceseve të anëtarësimit në BE, rolin e tyre dhe se si të angazhohen

Para se të ftojë OSHCG-të për të marrë pjesë në procesin e anëtarësimit në BE, RrGK kontribuon në rritjen e njohurive të tyre dhe informimin e organizatave bazë për rolin e rëndësishëm që kanë në këto procese. Më 12-15 tetor, RrGK në partneritet me Shoqatën Evropiane të Grave Avokate (EWLA) organizoi katër punëtori në internet mbi temën “Të Drejtat e Barabarta dhe Barazia Gjinore për gratë dhe burrat në Kosovë”, në të cilën afërsisht 58 anëtarë të stafit të RrGK-së, organizatat anëtare, anëtarët e Koalicionit për Barazi (CfE) dhe anëtarët e Lobit morën pjesë.



Lobi, anëtarët e Koalicionit dhe stafi i RrGK marrin pjesë në një punëtori katër-ditore mbi Acquis të BE-së për Barazinë Gjinore të bashkë-organizuar nga EWLA dhe RrGK në tetor 2020.

Drejtorja Ekzekutive e RrGK theksoi se “Acquis i BE-së për Barazinë Gjinore është një temë shumë e rëndësishme për t’u kuptuar mirë nga të gjithë ne dhe për t’u përdorur për avancimin e pjesëmarrjes së grave në disa sektorë.” Organizatat anëtare të RrGK diskutuan se si të avokojnë për ndryshime në lidhje me procesin e anëtarësimit në BE, veçanërisht nga perspektiva gjinore. Ato ndanë përvojat e tyre dhe planet e ardhshme në lidhje me zbatimin e Acquis të BE-së për Barazinë Gjinore në kontekstin e Kosovës. Stafi i RrGK-së përgjegjës për integrimin gjinor në procesin e Anëtarësimit në BE ndihmoi duke ndarë shembuj se si anëtarët mund të kontribuojnë dhe të përdorin Acquis të BE-së për Barazinë Gjinore për të avokuar për zbatimin më të mirë të legjislacionit për barazinë gjinore. Anëtarët pjesëmarrës fituan një kuptim më të mirë të Programit Kombëtar për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (NPISAA), strukturat e MSA-së, Raportin e Progresit të Kosovës, Agjendën Evropiane të Reformës II, dhe proceset e tjera të rëndësishme përmes të cilave ato mund të kontribuojnë.

RrGK do të vazhdojë konsultimin me OSHCG në lidhje me proceset e Anëtarësimit në BE dhe do të mbajë seanca më informuese në vitin 2021, pasi që ky objektivi ishte pak i kufizuar në vitin 2020 për shkak të masave të izolimit në lidhje me COVID-19.

“Kjo është një punëtori e shkëlqyeshme në të cilën diskutuam së bashku dhe ju ofruam mjetet dhe argumentet e nevojshme në mënyrë që të mund të përdorni Acquis të BE-së për Barazinë Gjinore në punën tuaj të përditshme.”

*Sylvia Cleff le Divellec, përfaqësuese e
EWLA*



Përmirësimi i njohuritë dhe të kuptuarit e palëve të interesit në lidhje me rëndësinë e përfshirjes së OSHCG-ve në proceset e anëtarësimit në BE

RrGK vazhdoi avokimin drejt avancimit të njohurive dhe kuptimit të palëve të interesuara për rëndësinë e përfshirjes së OSHCG-ve në proceset e anëtarësimit në BE. Ky proces i avokimit konsistoi në letra avokimi, takime avokimi dhe rekomandime përmes procesit të konsultimit publik mbi politikat e shumta publike. RrGK gjithashtu angazhoi OSHCG të tjera në përfshirjen gjinore të NPISAA 2020-2024, Raportin e Progresit të Kosovës 2020 dhe në paraqitjen e rekomandimeve për Nën-komitetin e MSA-së për Drejtësi, Liri dhe Siguri.

Një proces i suksesshëm i avokimit u zhvillua gjithashtu përmes javës së avokimit të BE-së të organizuar nga Fondacioni Kvinna till Kvinna, ku RrGK së bashku me anëtarët e saj u takuan me Përfaqësuesit e BE - Korneel de Schamp, Zyrtar i Zyrës për Sundimin e Ligjit dhe Eurodeputeten Viola Von Cramon, Raportuese Speciale për Kosovën. RrGK diskutoi me ta mbi përfshirjen e pamjaftueshme të grave në procesin e anëtarësimit në BE, midis çështjeve të tjera. Pas avokimit të RrGK, Von Cramon i drejtoi një letër shqetësimi Përfaqësuesit Special të BE-së, duke e pyetur atë për hapat e mëtejshëm që ai planifikon të ndërmarrë për të përfshirë më shumë gra në procesin e bërjes së paqes.

“Kontributi që marrim nga ju është shumë domethënës. Ne do të dëshironim të vazhdonim bashkëpunimin tonë në diskutime të tjera dhe të shohim se si mund të inkurajojmë bashkërisht më shumë gra që të përfshihen në mënyrë aktive në politikë.”

Eurodeputetja Viola von Cramon, Raportuese e PE për Kosovën

Përmirësimi i integritit të çështjeve gjinore në dokumentet që lidhen me anëtarësimin e Kosovës në BE dhe me zbatimin e tyre

Këtë vit, RrGK ka komentuar gjithsej në 16 politika, përfshirë katër prej tyre që kanë të bëjnë me anëtarësimin në BE:

- Procesi i konsultimit për Instrumentin e Ndihmës Para-Anëtarësimi (IPA)
- Raporti i Progresit të Kosovës 2020 (së bashku me Qendrën Kosovare për Studime Gjinore)
- Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2020-2024
- Draft Agjenda e Reformës Evropiane II

Pas avokimit të RrGK-së, si PKZMSA edhe Raporti i Progresit 2020 tregojnë një përmirësim të dukshëm në nivelin e integritit të çështjeve gjinore, duke përmendur të drejtat e grave dhe barazinë gjinore në më shumë pjesë.



Përmirësimi i njohurive dhe kapaciteteve të zyrtarëve të BE-së, Ministrisë së Integrimit Evropian, Mekanizmave Kombëtar për Barazi Gjinore si dhe ministrive të linjës lidhur me integrimin e perspektivës gjinore në dokumentet relevante për anëtarësimin në BE

RrGK ka vazhduar ofrimin e ndihmës teknike për BE-në në Kosovë në lidhje me proceset e integrimit të çështjeve gjinore, dokumentet e veprimit, kontratat dhe dokumentet tjera përkatëse. RrGK ka ofruar ngritjen e kapaciteteve si dhe rishikime të drejtpërdrejta dhe sugjerime në dokumente të ndryshme të BE-së. RrGK ka vazhduar bashkëpunimin e saj me ish-strukturat e Ministrisë së Integrimit Evropian, të shkruara në Zyrën e Kryeministrit. Njohuritë e tyre mbi integrimin e çështjeve gjinore në dokumentet e anëtarësimit në BE janë përmirësuar si rezultat i këtij bashkëpunimi, përfshirë edhe procesin e konsultimit publik. Dokumentet e anëtarësimit në BE tregojnë përmirësim të dukshëm në masën në të cilën ato i kanë integruara çështjet gjinore, megjithëse nevojiten përpjekje të mëtejme për të zbatuar zotimet. RrGK ka vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGJ), si mekanizmi kryesor i barazisë gjinore në Kosovë. Këtë vit, ABGJ përfundoi Programin Kombëtar të Kosovës për Barazinë Gjinore 2020-2024, duke marrë parasysh dhe duke i përfshirë të gjitha rekomandimet e ofruara nga RrGK gjatë procesit të hartimit.

Përmirësimi i aftësisë së komisioneve të ndryshme, sidomos komisionit për integrimin në BE, dhe OShCG-ve, për të monitoruar zbatimin nga perspektiva gjinore

Në lidhje me këtë, RrGK ka përdorur proceset e konsultimit me nën-komisionet e MSA-së për të avokuar për përmirësimin e perspektivës gjinore në Procesin e Anëtarësimit në BE, veçanërisht në lidhje me shpërndarjen e fondeve të ardhshme të IPA-s, çështjet e adresuara në Raportet e Progresit të Kosovës dhe zbatimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1325, për të informuar Strukturat e MSA-së që përfaqësojnë Kosovën dhe BE-në gjatë takimeve për MSA-në. Duke marrë parasysh që takimet me parlamentarë këtë vit ishin mjaft të kufizuara, RrGK adresoi si më poshtë:

- a) Letrat avokuese që shprehin shqetësime për mungesën e përfaqësimit të grave në dialogun politik, sipas RKSKB 1325;
- b) Letrat avokuese që adresojnë mungesën e zbatimit të LBGJ në listat zgjedhore, në lidhje me mungesën e grave kandidate,
- c) Letrat avokuese në lidhje me zbatimin dhe rëndësinë e Konventës së Stambollit,
- d) Letrat avokuese për mungesën e perspektivës gjinore në masat e marra për të luftuar Covid-19 dhe nevojën për zbatimin e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor në të gjitha masat e ardhshme;
- e) Monitorimi i hartimin e Ligjit të ri të Punës, së bashku me Forumin Ekonomik të Grave të Kosovës, duke theksuar nevojën që Ligji i Punës të jetë në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian, duke rikujtuar se drafti aktual i Ligjit të Punës është diskriminues ndaj grave, dhe duke këmbëngulur që ndryshimi në përputhje me Direktivën e BE-së për Ekuilibrin Punë-Jetë është prioritet.



f) Letrat avokuese që dënuan mungesën e zbatimit të Kodit Penal përkitazi me dënimet e kryesve të veprave dhe dënimet e lehta;

Kurdo që ishte e mundur, RrGK gjithashtu u takua me parlamentarë, përfshirë udhëheqësen e parlamentit - Vjosa Osmanin, për të diskutuar për Ligjin e Punës dhe nevojën për krijimin e një linje të përhershme buxhetore për strehimoret, avokim ky i cili rezultoi pozitiv pasi kjo linjë buxhetore u krijua këtë vit.

Përmirësimi i zbatimit të PVGJ II

Drejt implementimit të Planit të Veprim Gjinator të BE-së (PVGJ) II, RrGK ka punuar drejt arritjes së rezultateve në vijim.

Rritja e mëtejshme e ndërgjegjësimit të zyrtarëve të BE-së lidhur me nevojën për angazhim më të fuqishëm politik, buxhet të mjaftueshëm dhe burime të mjaftueshme njerëzore për zbatimin e PVGJ II.

Në vitin 2020, RrGK ka hartuar katër përmbledhje të politikave të cilat i kemi shkëmbyer me Komisionin e BE-së, përfaqësuesit përkatës të Parlamentit Evropian dhe Zyrën e BE-së në Kosovë (ZBEK), me rekomandime konkrete në lidhje me nevojën për angazhim më të fuqishëm, buxhet të mjaftueshëm dhe burime të mjaftueshme njerëzore për zbatimin e PVGJ II. Ato përfshinin:

1. Një qasje e përgjegjshme gjinore ndaj financimi të jashtëm të BE-së: Rekomandime për Rregulloren e re të përbashkët të zbatimit
2. Zbatimi i zotimeve të BE-së për Barazinë Gjinore: Mësimet e nxjerra nga PVGJ II për informimin e PVGJ III
3. Zbatimi i Zotimeve të BE-së: Rekomandime për Integrimin Gjinor në IPA III
4. Sa mirë e ka zbatuar BE-ja Planin e Veprimit Gjinor II në programet e Ballkanit Perëndimor : Analizë e programeve të Instrumentit për Para-Anëtarësim në 2014-2019 duke u bazuar në treguesit e Planit të Veprimit Gjinor II të BE-së

Gjithashtu janë mbajtur disa takime me përfaqësues të ZBEK-së me qëllim të përmirësimit të zbatimit të PVGJ II.

Rritja e mëtejshme e ndërgjegjësimit të zyrtarëve përkatës lidhur me reformat që kërkohen për dokumentet dhe shabllonet, drejt përmirësimit të zbatimit të PVGJ II

RrGK i shkëmbeu katër përmbledhjet e sipërpërmendura të politikave me zyrtarët përkatës nga Komisioni Evropian, Parlamenti Evropian, Instituti Evropian për Barazi Gjinore (EIGE) dhe delegacioni i BE-së në Kosovë. Në këtë mënyrë, RrGK rriti ndërgjegjësimin e zyrtarëve përkatës në lidhje me reformat e nevojshme, bazuar në rekomandimet e dokumenteve.



Rritja e mëtejshme e ndërgjegjësimit të personelit të BE-së dhe ShA-ve lidhur me PVGJ II dhe zbatimin e tij

Në vitin 2020, RrGK vazhdoi të punojë së afërmi me ZBEK drejt zbatimit të PVGJ II, duke përfshirë edhe mbështetjen e ZBEK-së në krijimin e një plani të veprimit për këtë qëllim. RrGK siguroi ngritjen e kapaciteteve, përfshirë mentorimin, këshillimin dhe trajnimin për tema të ndryshme në lidhje me PVGJ II. RrGK gjithashtu rishikoi dokumente në përputhje me PVGJ II. Kjo ka kontribuar në avancimin e ndërgjegjësimit në lidhje me PVGJ II dhe zbatimin e tij. Në vitin 2020, RrGK gjithashtu vazhdoi mbështetjen e partnerëve të ADA-së drejt përmirësimit të përgjegjshmërisë gjinore të programeve të tyre. RrGK mbështeti disa partnerë të ADA-së për ta integruar një perspektivë gjinore në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin projekteve të tyre.

Rritja e mëtejshme e ndërgjegjësimit në radhët e OSHCG-ve dhe MKBGJ-ve lidhur me PVGJ-në dhe mënyrën se si të përkrahet zbatimi i tij

Gjatë trajnimit me EWLA në muajin tetor, RrGK shpjegoi PVGJ II dhe rëndësinë e tij për OSHCG-të pjesëmarrëse si dhe mekanizmat kombëtar për barazinë gjinore (MKBGJ-të). RrGK gjithashtu iu referua PVGJ-së në punën e saj të avokimit me OSHCG-të tjera në rajon.

Përmirësimi i projektimit të PVGJ III, bazuar në mësimet e nxjerra nga PVGJ II

Në vitin 2020, RrGK u përpoq të bënte përparim drejt këtij objekti përmes rezultatit në vijim:

Rritja e mëtejshme e ndërgjegjësimit lidhur me përmirësimet e nevojshme në PVGj III

Drejt këtij objekti, RrGK publikoi një përmbledhje të politikave “Zbatimi i zotimeve të BE-së për Barazinë Gjinore : Mësimet e nxjerra nga PVGJ II për informimin e PVGJ III. RrGK shpërndau rekomandimet te disa palë të interesit në Bruksel, me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit të tyre rreth përmirësimeve që mund të bëhen në PVGJ III, bazuar në mësimet e nxjerra nga PVGJ II.

Përmirësimi i transpozimit të Acquis të BE-së për Barazinë Gjinore në Ligjin e Kosovës

RrGK vazhdimisht monitoron transpozimin e Acquis të BE-së për Barazinë Gjinore në Ligjin e Kosovës, si një nga kushtet kryesore për avancimin e procesit të anëtarësimit të Kosovës në BE. RrGK ka komentuar në disa dokumente thelbësore të lidhura me anëtarësimin në BE, duke sugjeruar transpozim më të mirë të Acquis të BE-së për Barazinë Gjinore, në veçanti të direktivave të BE-së për të drejtat e grave, shtatzëninë dhe barazisë gjinore, me fokus në direktivën e BE-së për ekuilibrin punë-jetë. Megjithatë këto rekomandime janë pasqyruar dhe përfshirë në disa politika, ka ende mungesë të zbatimit. RrGK do të vazhdojë të monitorojë dhe avokojë për zbatimin e tyre.

ABGj, MIE dhe MPMS të informohen më mirë në lidhje me nevojat për përmirësimin e transpozimit të Acquis të BE-së për Barazinë Gjinore në Ligjin e Kosovës

RrGK vazhdimisht mbështet një transpozim më të mirë të Acquis të BE-së për Barazinë Gjinore në Kosovë. RrGK ka ofruar kontribut të rëndësishëm drejt transpozimit më të mirë të Acquis të BE-së për



Barazinë Gjimore gjatë procesit të finalizimit të PKBGJ 2020-2024. MIE-ja e mëparshme gjithashtu ishte informuar vazhdimisht në lidhje me nevojat e transpozimit gjatë bashkëpunimit në hartimin e ARE, PKZMSA si dhe në takimet e konsultimit për MSA-në. RrGK ka mbajtur shumë takime avokimi me MPMS, për t'i informuar në lidhje me transpozimin më të mirë të Acquis të BE-së për Barazinë Gjimore në lidhje me Projektligjin e Punës.

Të drejtat e grave në kujdesin shëndetësor

Qëllimi afatgjatë i këtij programi është t'u sigurojë grave qasje në kujdes shëndetësor cilësor me kosto të përballueshme. Ndërsa shëndeti riprodhues i grave duket se është në qendër të shumicës së aktiviteteve zhvillimore, RrGK e konsideron shëndetin e përgjithshëm të grave po aq të rëndësishëm. Ndërsa burimet për punën në lidhje me përmirësimin e qasjes së grave në kujdesin shëndetësor cilësor mbeten të kufizuara, është arritur përparim i caktuar drejt këtij objekti falë punës së anëtareve të RrGK-së, të mbështetura nga RrGK, përmes disa iniciativave të cilat janë në vazhdim e sipër. Më tej, RrGK ka mbledhur fonde për të siguruar më shumë fonde për anëtarët e saj me qëllim që të mbështesë punën e tyre të ardhshme në zbatimin e këtij objekti. Kjo vlen veçanërisht pasi që epidemia COVID-19 ka nxjerrë në pah sfidat specifike me të cilat gratë e ndryshme mund të përballen në sigurimin e kujdesit shëndetësor cilësor.

Jeta pa dhunë me bazë gjinore

Qëllimi kryesor i këtij programi është që gratë dhe vajzat të jetojnë një jetë të lirë nga dhuna me bazë gjinore. Drejt kësaj, pas avokimit të pandalur të RrGK dhe anëtareve të saj, me 25 shtator 2020, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka votuar për amandamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kështu zyrtarisht duke përfshirë dhe duke e bërë direkt të zbatueshme Konventën e Këshillit të Evropës në parandalimin dhe luftimin e dhunë ndaj grave dhe dhunës në familje, gjithashtu e njohur edhe si Konventa e Stambollit. Vetë Konventa vendosë standarde për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Ajo poashtu njeh obligimin e shteteve që plotësisht ta adresojnë dhunën me bazë gjinore dhe të gjitha format e saj, si dhe të marrin masa në parandalimin e dhunës ndaj grave, të mbrojnë viktimat dhe të ndjekin penalisht kryesit e veprës. Ky ishte një rezultat shumë i rëndësishëm i RrGK dhe anëtareve të saj, ndër tjerash këtë vit, që u arritë përmes avokimit të pandalshëm.



Përmirësimi i zbatimit të kornizës ligjore për dhunën në familje, duke përfshirë përgjegjësinë institucionale për të ndihmuar personat që kanë pësuar dhunë

Në vitin 2020, RrGK zhvilloi një hulumtim për raportin e saj të pestë të monitorimit mbi dhunën me bazë gjinore (DhBGJ) në Kosovë, i cili pason raportet e mëparshme të monitorimit nga RrGK-ja: *Siguria fillon në shtëpi* (2008); *Më shumë se vetëm fjalë në letër* (2009); *Mjaft më me arsyetime* (2015); *Nga Fjalët në Vepra* (2018). Ekipi hulumtues zhvilloi intervista me institucionet që janë përgjegjëse për adresimin e dhunës me bazë gjinore sipas Kodit Penal, Procedurave Standarde të Veprimit, Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Planit të Veprimit 2016-2020, dhe kornizat e tjera ligjore përkatëse. Intervistat u kryen me strehimore, policinë (rurale dhe urbane), gjyqtarë, prokurorë, mbrojtës të viktimave, qendra për punë sociale, financues të përfshirë në DhBGJ-në, mjekë, infermierë, Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, Institutin e Kosovës për Administratë Publike, OSHC-të e ndryshme dhe përfaqësues të ministrive dhe komunave në të shtatë rajonet e Kosovës. Raporti do të publikohet në fillim të vitit 2021. Gjetjet nga ky raport do të ofrojnë informacione mbi avokimin e RrGK-së drejt përmirësimit të zbatimit të kornizës ligjore në lidhje me dhunën në familje, ndër llojet e tjera të DhBGJ-së.

Tutje, përmes ndihmës juridike, RrGK ka mbështetur gratë që të kërkojnë drejtësi për dhunën të cilën e kanë përjetuar, duke kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e zbatimit. Ekipi kundër DhBGJ-së ka mbështetur afërsisht 25 raste gjatë kësaj periudhe, duke i informuar gratë për të drejtat e tyre, institucionet të cilave ato mund të i drejtohen dhe duke i referuar ato tek një avokat për ndihmë juridike. Gratë u referuan tek institucionet përkatëse të drejtësisë, si dhe psikologë të strehimoreve për këshillim. Si rezultat i këtyre referimeve, avokati i RrGK-së ka filluar procedurat në lidhje me pesë raste në zhvillim e sipër në gjykata dhe institucione të tjera. RrGK gjithashtu kishte monitorues të gjykatave të cilët ndiqnin rastet e DhBGJ-së në gjykata, në drejtim të identifikimit të rekomandimeve për përmirësimin e zbatimit të kornizës ligjore.



Përfaqësuesit e RrGK-së dhe EULEX-it diskutojnë për përmirësimin e përgjigjes ndërinstitucionale ndaj dhunës me bazë gjinore në Kosovë në Shtator të vitit 2020.

Zgjerohen njohuritë në lidhje me me shkallën në të cilën është zbatuar korniza ligjore që ka të bëjë me dhunën në familje, si dhe vetëdijesimi dhe prevalencën e dhunës në familje

Raporti i ardhshëm i hulumtimit do të informojë RrGK-në dhe palët e interesuara përkatëse për ndryshimet në njohuri në mesin e institucioneve të ndryshme që nga viti 2015. Bazuar në gjetjet, RrGK do të organizojë nisma avokimi të mbështetura nga anëtarët, për të siguruar që përfaqësuesit institucionalë dhe OSHCG-të që ofrojnë shërbime për gratë dhe vajzat që kanë përjetuar DhBGJ-ja të kenë njohuri të rritura. Për të rritur vetëdijësimin e qytetarëve, RrGK organizoi fushata të ndryshme të mediave sociale. RrGK gjithashtu rihapi ekspozitën e saj “Thyeje heshtjen: Dhuna nuk fshehet mrena mureve”, e cila synon informimin e qytetarëve për llojet e ndryshme të dhunës, përhapjen e dhunës dhe ofron informacione të detajuara për secilin institucion, përgjegjësitë e tyre dhe informatat kontaktuese. Për shkak të pandemisë COVID-19, RrGK, së bashku me strehimoret dhe qendrat ditore, u përqendruan në rritjen e kapaciteteve për të mbështetur gratë që përballen me DhBGJ gjatë mbylljes, posaçërisht gjatë masave të izolimit. Atyre u janë ofruar gjësende për mbrojtje personale sikurse produkte për pastrim, produkte të higjienës, ushqim dhe gjëra

“Ekspozita ka vazhduar këtë vit, përkundër që, për fat të keq, kishte një rritje alarmante të rasteve të dhunës në familje gjatë karantinës dhe kufizimeve të lëvizjes.”

Adelina Berisha, Menaxhere e
Programit për Adresimin e Dhunës në
Bazë Gjinore, RrGK

të tjera esenciale, bashkë me lirim e fondit të emergjencës. Të dhënat zyrtare treguan se gjatë pandemisë pati një rritje prej 30% të rasteve të raportuara të dhunës në familje.

Institucionet dhe akterët e tjerë të vetëdijshëm për shkallën në të cilën korniza ligjore për dhunën në familje është zbatuar

RrGK vazhdoi me monitorimin e rasteve të DhBGJ-së të drejtuara Departamentit për Krime të Rënda në Gjykatat Themelore të Kosovës. Ky proces monitorimi zgjati nga muaji shkurt deri në mars dhe më pas nga maji deri në korrik në tetë gjykata themelore: Prishtinë, Podujevë, Pejë, Istog, Prizren, Suharekë, Ferizaj dhe Gjiilan. Në muajin prill, monitorimi nuk ishte i mundur për shkak të mbylljeve dhe izolimit që lidhen me COVID-19. Gjatë kësaj periudhe, monitoruesit punuan nga shtëpia, duke kryer analiza të mëtejshme të rasteve të tyre gjyqësore të monitoruara më parë dhe duke i elaboruar raportet e monitorimit. Në total, gjashtë monitorues kanë ndjekur 398 seanca gjyqësore dhe kanë përpiluar 33 raporte. Tutje, si pjesë e hulumtimit, RrGK takoi dhe intervistoi 189 përfaqësues institucionalë, shoqërië civile dhe organizatat ndërkombëtare për të matur ndërgjegjësimin dhe qëndrimet e tyre në lidhje me DhBGJ-në. Pas publikimit të raportit të ardhshëm të hulumtimit për DhBGJ-në në Kosovë, RrGK do të organizojë takime avokimi për t'i informuar institucionet përkatëse dhe qytetarët në lidhje me shkallën deri në të cilën korniza ligjor për dhunën në familje është zbatuar. Përmes këtyre takimeve të avokimit, RrGK do të kërkojë të adresojë rekomandimet hulumtuese në lidhje me zbatimin e kornizës ligjore.



RrGK dhe anëtarët e saj të angazhuara për zbatimin e kornizës ligjore për dhunën në familje

RrGK bashkëpunoi me ofruesit e shërbimeve të OSHC-ve dhe kryesisht me strehimoret, përmes këshillimit dhe referimit të rasteve të dhunës në familje. Përmes bashkëpunimit me strehimoret, RrGK ka promovuar më tej bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ka ngritur vetëdijësimin për mekanizmat e ndryshëm të referimit në dispozicion për të mbijetuarit dhe ofruesit e shërbimeve. Në tërësi, 277 gra dhe fëmijë u mbështetën, këshilluan dhe referuan nga strehimoret. Deri më tani, çdo grua ishte informuar për të drejtat e saj dhe rolin e institucioneve.

Më 16 mars, Kosova zbatoi masat e mbylljes për shkak të pandemisë COVID-19. RrGK u përgjigj shpejt duke siguruar që strehimoret dhe ofruesit e shërbimeve të kishin qasje në pajisjet e mbrojtjes personale, si dhe pajisje të tjera emergjente në mënyrë që të funksiononin. RrGK u përgjigj kërkesave të ndryshme mediatike dhe institucionale në lidhje me



Organizata anëtare e RrGK-së “Hareja” mban një tryezë të rumbullakët rreth parandalimit të dhunës dhe rëndësisë së raportimit të dhunës, në kuadër të iniciativës “Mos heshtni-flisni”.

DhBGJ-në dhe rritjen e saj të mundshme në këtë situatë. RrGK zhvilloi konsultime të shpejta me të gjitha organizatat e saj anëtare për të vlerësuar nevojat e tyre dhe për të mbledhur fonde për të përmbushur çfarëdo nevojë urgjente. RrGK gjithashtu zhvilloi hulumtime të shpejta dhe publikoi rekomandime për qeverinë, e cila nuk kishte zhvilluar si duhet analizën gjinore për të informuar në lidhje me përgjigjen e saj ndaj COVID-19 ose ndikimin e mundshëm të procedurave të mbylljes nga perspektiva gjinore.

RrGK monitoroi efektet e COVID-19 në DhBGJ e cila zbuloi urgjencën e një koordinimi më të mirë në lidhje me financimin e strehimoreve dhe në fushatat e ndërgjegjësimit publik në lidhje me DhBGJ-në. RrGK avokoi tek institucionet vendore dhe ndërkombëtare për një përgjigje të përmirësuar, të koordinuar më mirë, të përbashkët. Kjo kontribuoi në krijimin e nën-grupit për DhBGJ-në, të udhëhequr nga ABGJ-ja.

Tutje, RrGK u takua me Avokatin e Popullit të posa emëruar për të diskutuar bashkëpunime në rishikimin e rasteve në gjykata, gjë që pritet të vazhdojë përgjatë vitit 2021.

Rritja e performancës dhe cilësisë së shërbimeve të strehimoreve, veçanërisht në drejtim të rehabilitimit dhe riintegrit

RrGK, së bashku me Qendrën e Grave Autonome në Serbi, ka filluar krijimin e një protokollit për të mbështetur gratë që kanë pësuar dhunë përmes telefonit. Kjo përfshin shkëmbimin e njohurive dhe praktikave ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për të diskutuar dhe finalizuar protokollin në fillim të vitit 2021.

Që nga viti 2012, RrGK ka avokuar për një buxhet të mjaftueshëm për të mbuluar të gjitha shpenzimet e nevojshme për strehimoret për të mbrojtur gratë dhe fëmijët që kanë përjetuar dhunë. Pas



avokimit nga RrGK-ja, për strehimoret dhe qendrat ditore, parlamenti i Kosovës në vitin 2019 caktoi një buxhet për strehimoret dhe qendrat ditore. Sidoqoftë, strehimoret ende u përballen me probleme në marrjen e këtyre fondeve për shkak të situatës së paqëndrueshme politike. Përkundër avokimit, alokimi i fondeve ishte shumë i vonuar dhe ishte më i pakët sesa ishte parashikuar. Mungesa e financimit të mjaftueshëm, shoqëruar me vonesat për marrjen e një financimi të tillë, i vuri gratë dhe fëmijët në rrezik. Për të adresuar këtë çështje dhe për të identifikuar një zgjidhje më të qëndrueshme, në muajin shkurt të vitit 2020, RrGK u takua me Kryeministrin e sapo zgjedhur të Kosovës Albin Kurti, dhe më pas me Ministren e re të Drejtësisë Albulena Haxhiu dhe me Kryetaren e re të Kuvendit të Kosovës Vjosa Osmani, përkatësisht. Gjatë këtyre takimeve, RrGK avokoi për një linjë të përhershme buxhetore që i dedikohet strehimoreve dhe qendrave ditore. Duke iu përgjigjur këtyre kërkesave, Osmani premtoi të mbështesë RrGK-në në qëllimin e tyre për të krijuar një linjë të veçantë buxhetore për strehimoret. Më 15 mars, parlamenti e miratoi buxhetin për vitin 2020, i cili përfshinte 900,000 € për strehimoret dhe qendrat ditore në Kosovë.

Më 6 tetor, RrGK, strehimoret dhe qendrat ditore kundër dhunës ndaj grave, i dërguan një letër të hapur Kryeministrit Avdullah Hoti, Ministres së Ministrisë së Financave, Hykmete Bajrami dhe Ministrin të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, për të kërkuar miratimin me kohë të Ligjit të ri për Buxhetin e vitit 2021, përfshirë financimin për strehimoret dhe qendrat ditore. Linja e re për Shërbimet për Strehimoret është rritur në vitin 2021, duke arritur në një total prej një milion eurosh. Këto përpjekje ishin rezultat i lobimit nga RrGK-ja, strehimoret dhe qendrat ditore.

Përmirësimi i vetëdijesimit dhe vëmendjes në mesin e zyrtarëve dhe qytetarëve, në trajtimin e dhunës me bazë gjinore duke përfshirë dhunën në familje, përdhunimin dhe ngacmimin seksual

Sikur në vitet e mëparshme, më 8 Mars, në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, RrGK iu bashkëngjit marshit protestues “Marshojmë S’Festojmë”. Përveç marshit në Prishtinë, këtë vit aktivistet organizuan marshime të ngjashme në Ferizaj dhe Mitrovicë.

RrGK edhe një herë ngriti zërin e saj kundër dhunës ndaj grave në Kosovë më 16 qershor. “Mos i jep zemër dhunuesit” dhe “Nuk ka më arsytim” – ishin në mesin e parullave që stafi i RrGK-së i mbajtën në duar në protestën e organizuar para Prokurorisë në Prishtinë. Aktivistet dëshironin të ngrinin zërin e tyre kundër dhunës dhe vrasjes së grave dhe kundër dënimeve të shumta të



Stafi i RrGK-së marshojnë për të drejtat e grave në muajin mars 2020.

shkurtra që kanë marrë kryerësit e veprave këtë vit. Ato siguruan që po mbanin distancën e tyre fizike gjersa mbanin maska dhe po kufizonin numrin e pjesëmarrësve. Siç u cek, RrGK gjithashtu mbajti disa takime avokimi me zyrtarë për të rritur ndërgjegjësimin e tyre për mangësitë në zbatimin e kornizës relevante ligjore dhe rekomandimet për përmirësimin e zbatimit.

Më shumë qytetarë të informuar në lidhje me kornizën ligjore dhe të drejtat e tyre

Më 30 tetor, RrGK rihapi ekspozitën “Thyeje heshtjen: Dhuna nuk fshehet mrena mureve”. Ekspozita i informon qytetarët për format e ndryshme të dhunës, se ku mund ata të raportojnë dhunën, si dhe ofron informacione të hollësishme për rolet dhe përgjegjësitë e secilit institucion. Rreth 70 gra dhe 77 burra morën informacione në lidhje me institucionet përkatëse, të cilat janë përgjegjëse për dhunën në familje.

Për shkak të situatës me COVID-19, RrGK u desh të shtynte organizimin e ekspozitës në komunat e tjera. Në mënyrë që të sigurohet shpërndarja e duhur e informacionit të ofruar përmes ekspozitës, RrGK angazhoi një kompani për të regjistruar dhe bërë



Një qytetar lexon përmbledhjen e ekspozitës në muajin tetor 2020.

një film nga ekspozita. Kjo do t'i mundësojë RrGK-së që të ndajë më tej filmin informues gjatë gjithë vitit dhe vitin e ardhshëm, duke synuar kështu më shumë audiencë.

Për më tepër, e mbështetur nga FGK, anëtarët e RrGK-së: Shoqata për Edukim dhe Përkujdesjen e Familjes, Femrat Aktive të Gjakovës dhe Shoqata e Pavarur e Gruas Hareja, e ngritën vëtedijën e 913 grave dhe burrave në komunitetet e tyre për dhunën me bazë gjinore. RrGK gjithashtu i ndihmoi strehimoret në shërbimet e tyre të këshillimit në lidhje me të drejtat ligjore dhe ofroi referime tek avokati i RrGK-së, sipas nevojës.



Përmirësimi i politikave dhe procedurave për adresimin e ngacmimit seksual

Koordinimi mes OSHC-ve të udhëhequra nga gratë, institucioneve publike dhe vendeve tjera të punës është përmirësuar në aspektin e instalimit të mekanizmave më të mirë për raportimin dhe hetimin e rasteve të ngacmimit seksual

Më 25 nëntor, në kuadër të 16 ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore, Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, nënshkroi Politikën kundër Ngacmimit Seksual në Administratën Publike. QKSGJ, një anëtare e RrGK-së, në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë (ZQM), përgatiti Politikën kundër Ngacmimit Seksual në Administratën Publike në Kosovë në zbatim të Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Ligjit nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore. Politika synon krijimin e një mjedisi të punës, ku çdo formë e ngacmimit seksual parandalohet dhe sanksionohet.



QKSGJ dhe Kryeministri Hoti flasin me rastin e nënshkrimit të Politikës kundër Ngacmimit Seksual në Administratën Publike në Kosovë në nëntor të vitit 2020

Përmirësimi i mbështetjes institucionale dhe publike për personat që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës

Në 20 vjetorin e Rezolutës 1325 të KB për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, RrGK i dërgoi një letër të hapur Përfaqësuesit Special të BE-së për Dialogun Beograd-Prishtinë, Miroslav Lajçak. RrGK radhiti përparësitë kryesore të grave gjatë dialogut në zhvillim e sipër me Serbinë. Kjo përfshin ndjekjen penale të njerëzve që kanë kryer krime të ndryshme, përfshirë dhunën seksuale të kryer gjatë kohës së luftës.



RrGK dhe anëtarët e saj përkrahin personat që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës

Viktimat e dhunës në familje ashtu si edhe të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë periudhës tani do ta kenë më të lehtë të gjejnë punë. Kjo u bë e mundur falë një Memorandumi të Mirëkuptimit (MM), të nënshkruar më 8 korrik, midis Ministrisë së Drejtësisë, Rrjetit të Shitjes me Pakicë dhe RrGK-së, bazuar në një iniciativë të grave të KB.

Vetëdijësimi dhe vëmendja në lidhje me trajtimin e dhunës me bazë gjinore në mesin e zyrtarëve dhe qytetarëve është përmirësuar, përfshirë dhunën në familje, përdhunimin dhe ngacmimin seksual

RrGK kishte më shumë se 119 raste të mbulimit nga mediat, të cilat ngritën vetëdijen e qytetarëve për dhunën në familje. RrGK gjithashtu pati disa fushata në mediat sociale në internet të cilat e ngritën vëmendjen në lidhje me format e ndryshme të dhunës me bazë gjinore.



RrGK, Ministria e Drejtësisë dhe Rrjeti i Shitjes me Pakicë në korrik të 2020 nënshkruajnë një Memorandum për Punësimin e Viktimave të Dhunës në Familje dhe Dhunës Seksuale Gjatë Luftës.

Fuqizimi Ekonomik i Grave

Qëllimi afatgjatë i këtij programi është që gratë dhe burrat të kenë mundësi të barabarta ekonomike në shtëpi dhe në sferën publike. Në drejtim të këtij qëllimi është bërë përparim, siç ilustron nga hapat e ndërmarrë për të realizuar objektivin dhe rezultatet e mëposhtme.

Përmirësimi i kushteve për pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore

Në vitin 2020, RrGK së bashku me organizatat e saj partnere dhe anëtarët e Koalicionit Rajonal kundër Diskriminimit me Bazë Gjinore në Punë, mbajtën 44 takime për të planifikuar dhe ndërmarrë një avokim të përbashkët për zbatimin e legjislacionit kundër-diskriminimit. Përveç kësaj, me mbështetjen e partnerëve dhe përfituesve të nën-granteve nga rajoni, 56 raste të diskriminimit me bazë gjinore në punë iu raportuan zyrtarëve. Shumica e përpjekjeve në kuadër të këtij objekti mbështeten nga BE-ja dhe bashkë-financohen nga Sida. Për arritjen e këtij objekti, është bërë progres në rezultatet e pritura në vijim.

“Përveç të jetuarit në kushte të vështira, gratë e këtij rajoni gjithashtu përjetojnë izolimin dhe marginalizimin nga familjet e tyre dhe shoqëria në përgjithësi.”

*Pranvera Hajzeri-Bullaku, Drejtore
e Organizatës Rikotta*



Institucionet dhe akterët kryesorë më të vetëdijshëm për shkallën e diskriminimit gjinor në vendin e punës në Kosovë dhe mënyrat për ta adresuar atë

Vitin e kaluar, RrGK, së bashku me partnerët e saj rajonalë, botuan shtatë raporte për diskriminimin me bazë gjinore dhe punën në rajon, duke përfshirë një raport për secilin nga gjashtë vendet e BP-së dhe një raport rajonal. Këto raporte përmbanin rekomandime specifike për institucionet për të adresuar më mirë diskriminimin me bazë gjinore. Këtë vit, RrGK mbajti 42 takime të ndara me palët e interesit për të diskutuar rekomandimet. Gjatë këtyre takimeve, partnerët ngritën vetëdijësimin e palëve të interesuara në lidhje me kornizën ligjore, bazën e të dhënave dhe hapat e tjerë për parandalimin dhe ndjekjen e rasteve të diskriminimit me bazë gjinore. Për më tepër, mediat mbuluan çështjet që lidhen me diskriminimin ndaj grave në punë 60 herë, duke kontribuar në vetëdijësimin në lidhje me këtë temë. RrGK bashkëpunoi me partnerët e saj, ABGJ-në dhe Institucionin e Ombudspersonit për shpërndarjen e informacioneve.



Organizata anëtare e RrGK-së “Okarina e Runikut” mban një tryezë të rrumbullakët në muajin korrik 2020 në kuadër të iniciativës “Promovimi i punësimit për përfituesit e Skemës së Sociale në Rajonin e Drenicës”, e mbështetur nga FGK.

Vetëdijesimi në mesin e palëve të interesit, duke përfshirë zyrtarët, OSHC-të dhe sindikatat lidhur me kornizën ligjore për diskriminimin përkatës dhe me mënyrat për përmirësimin e zbatimit të saj

Rrjeti, në bashkëpunim me partnerët e saj rajonale, mbajti 35 takime për ngritjen e vetëdijesimit të palëve të interesit. Me marrjen pjesë në panele, seminare, konferenca dhe punëtori të ndryshme, përfaqësuesit e këtij koalicioni kanë rritur vetëdijësimin e palëve të interesit për konceptet e diskriminimit dhe mënyrat për ta parandaluar atë. Koalicioni i lartpërmendur i koordinuar nga RrGK-ja ka nisur një fushatë në internet përmes të cilës i informon punëtorët për shkeljet e mundshme të të drejtave, përfshirë gjatë punës në kushte pandemie. Fushata gjithashtu i ofroi informacione njerëzve për ndihmën juridike falas nëse ata dëshirojnë të raportojnë për diskriminimin me bazë gjinore dhe shkeljet e të drejtave të grave punonjëse.



Disponueshmëria e informacionit, përfshirë hende kun gjinor të pagave, ekonominë joformale dhe skemat e sigurimit sociale është përmirësuar

RrGK nisi një iniciativë të re të financuar nga BE-ja mbi “Avancimin e Barazisë Gjinore përmes Anëtarësimit në BE”. Një aktivitet do të përfshijë zhvillimin e analizave gjinore të sektorëve të paanalizuar për të informuar në lidhje me procesin e anëtarësimit në BE. Në vitin 2020, RrGK mbajti konsultime me



palët e interesit dhe bazuar në këto ka vendosur që analizën e saj të ardhshme e cila do të fillojë në vitin 2021 ta përqëndroj në ekonominë joformale. Disponueshmëria e informacioneve mbi ekonominë joformale është bërë shumë e rëndësishme edhe në lidhje me adresimin e COVID-19.

Qasja në drejtësi në rastet e diskriminimit gjinor në punë është përmirësuar

	së Gjakovës në subvencion et Kosovare		ndryshoj përmabjtjen e thirrjes për aplikim për zubvencione për fermeret dhe biznese të vogla apo të mesme. IFK do të punoj së bashku me autoritetet lokale për të përfshirë një kuotë për gra dhe burra. Përmes kësaj iniciative gratë do të asistohen në përgaditjen e aplikacionit për grant. Do të organizohen edhe tri tryeza të rrumbullakëta me vendimmarrësit kryesorë në komunën e Gjakovës, sikurse me Kryetarin dhe me Drejtorët e Bordit. Në këtë mënyrë vitin e ardhshëm thirrja për aplikim mund të ndryshoj dhe do të bëhen alokime të granteve në mënyrë proporcionale për gra dhe burra.	

Organizata	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën	Rezultatet
Art Without Limit	Festivali ndërkombëtar i filmit për personat me nevoja të veçanta	3,750€	Kanë për qëllim të ngrisin zërin e grave dhe vajzave, specifikisht të atyre me nevoja të veçanta, në vendimmarrje dhe lirinë e të shprehurit. Gjatë zbatimit të iniciativës, “Festivali i filmit ndërkombëtar për personat me nevoja të veçanta” do të mbahet ku do të shfaqen filma që tregojnë qartë se si një grua është e aftë të kujdeset për veten dhe se si ajo mund të kontribuojë në shoqëri. Gjithashtu do të ketë filma që flasin për barazinë gjinore, dhunën në familje, dhe edukim cilësor.	Nga 500 filma me të cilët kanë aplikuar nga 120 shtete të botës, nga vende lokale dhe ndërkombëtare, 40 filma janë përzgjedhur për tu shfaqur gjatë festivalit 3 ditorë. 850 gra dhe vajza me nevoja të veçanta janë vetëdijësuar për tema të ndryshme sikurse: “Së bashku ne mundemi” “Ndal dhunën në familje” “Të drejtat e grave, veqanërisht të atyre me nevoja të veçanta”
Rikotta & ATO	Fuqizimi ekonomik dhe ngritja e	5,810€	Rikotta dhe Ato, kanë për qëllim fuqizimin ekonomik të grave duke punësuar dhjetë gra përmes zyrës komunale për punësim. Gratë dhe	85 gra dhe vajza janë informuar më detajisht për mundësitë e punësimit dhe përfshirjes së punëtorëve. 10

Organizata	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën	Rezultatet
	kapaciteteve të grave në Prevallë dhe fshatrat përreth!		vajzat poashtu do të motivohen të regjistrohen tek kjo zyrë. Target grupet janë 90 gra Boshnjake dhe Gorane nga Prevala dhe fshatrat përreth sikurse Mushnikova, Gornosella, Recani, Grnqare dhe Lubinje. Ato do të bashkëpunojnë me zyrën për punësim në komunën e Prizrenit, Drejtorinë për Ekonomi, Agrokulturë, Pylltari dhe Zhvillim Rural, dhe Drejtorinë e Arsimit. Një memorandum bashkëpunimi do të nënshkruhet me këtë të fundit, duke definuar kriteret që favorizojnë përkrahjen e grave dhe vajzave nga vendet rurale në sektorin e agrokulturës si masë afirmative për fuqizimin e tyre ekonomik.	gra janë punësuar përmes Agjencisë për punësim. 85 gra dhe vajza janë trajnuar në fusha të ndryshme sikurse: Çka është avokimi dhe mënyrat për avokim tek institucionet relevante. Një Memorandum Bashkëpunimi është nënshkruar me Drejtorinë për Ekonomi, Agrokulturë, Pylltari dhe Zhvillim Rural, duke definuar kriteret që favorizojnë mbështetjen e grave dhe vajzave rurale në sektorin e agrokulturës si një masë afirmative për t'i fuqizuar ato ekonomikisht.

Organizata	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën	Rezultatet
Organizata Lulishtja	Avokim për fuqizimin ekonomik të grave fermere në fshatrat e Malësisë së Gollakut	3,080€	Organizata Lulishtja ka për qëllim të fuqizoj gratë ekonomiksht duke avokuar dhe duke i informuar gratë fermere potenciale për subvencionet dhe zhvillimin ekonomik. Përfitueset do të jenë 85-100 gra fermere nga Gollaku, në fshatrat e Dabishec, Hajkobillë, Glllogovica, Mramor, dhe Keqekollë. Ato gjithashtu do të bashkëpunojnë me Ministrinë e Agrokulturës, Komunën e Prishtinës, Drejtorinë e Zhvillimit Rural dhe Zyrën për barazi gjinore. Do të mbajnë takime me bizneset NTP 'Euro fruit: dhe LLC.K "99 lule", në Prishtinë, me të cilët do të krijojnë një Memorandum bashkëpunimi. Me këto biznese shpresojnë të krijojnë	Kanë krijuar një Memorandum të Bashkëpunimit nëmes të Drejtorisë së Agrokulturës në komunën e Prishtinës dhe bizneseve NSHT "valeriana" dhe "99 lule" në fshatrat e Malësisë së Gollakut për t'i ndihmuar grave në fillimin e bizneseve dhe shitjen e produkteve. Startegjia për

Organizata	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën	Rezultatet
			një bashkëpunim me gratë që kanë për qëllim të fillojnë prodhimin në agrokulturë.	
Kosovo Advocacy Group (KAG)	Pjesëmarrja e grave të komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian në politikëbërje		KAG ka për qëllim të identifikoj sfidat dhe të ofrojë aktivitete konkrete të cilat do të fuqizojnë gratë dhe vajzat Rome, Ashkalike dhe Egjiptiane, me njohuri, dhe avancim të shpejtë në udhëheqje përmes mekanizmave adekuat. Gjatë zbatimit të 107 iniciativave, KAG do të bashkëpunoj me National Democratic Institute, zyrën e kryeministrit, Rrjetin e grave Rome, Ashkalike dhe Egjiptiane, qendrat për të rinjë dhe RTK1 dhe 2, dhe përfaqësues të ndryshëm të shoqërisë civile. Poashtu do të ketë media të ftuara në aktivitete, si dhe do të	Kontrata është ndërprerë.

Organizata	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën	Rezultatet
			bashkëpunojnë me Universitetin e prishtinës. Komunitet e targetuara janë Istog, Prizren, Gjakova, Fushe Kosova, Ferizaj, dhe Mitrovica.	

Gjatë raundit të 14-të të granteve, 19 grante shtesë iu dhanë 20 organizatave anëtare të RrGK-së, njëra në partneritet, që kapin shumën totale prej 59,266 €.

Organizata	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën	Rezultatet
EcoKos Women	Avokimi për qasje më të lehtë të grave në grante në komunën e Prishtinës	3,649€	102 gra dhe 1 burrë mësuan rreth teknikave dhe metodave të avokimit. U mbajtën 6 sesione informuese, të cilat i inkurajuan gratë që të avokonin tek vendimmarrësit për të rritur numrin e grave fermere që përfitojnë nga subvencionet dhe grantet.	Gjetjet dhe rekomandimet e projektit iu drejtuan Drejtorisë së Bujqësisë në Komunën e Prishtinës. Tri gra u regjistruan si punëkëruese në

Organizata	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën	Rezultatet
				Zyrën e Punësimit.
Shoqata e Gruas Aureola	Avancimi i ligjit për trashëgiminë	2,300€	Përmes kësaj iniciative Aureola synon të ndryshojë Ligjin për Trashëgiminë nr. 2004/26. Do të organizohen nëntë takime me vendimmarrësit kryesorë, përfshirë grupet parlamentare të partive politike, si dhe mediat lokale. Do të organizohen tryeza të rrumbullakëta për të prezantuar një propozim për ndryshimin e Ligjit për Trashëgiminë.	18 gra dhe vajza nga komuna të ndryshme në Kosovë janë informuar për të drejtat e garantuara me Ligjin e trashëgimisë.
Shoqata e Grave Penzioniste "Vita-Jeta"	Diabeti tek personat e moshuar	2,030€	Ato synojnë të ngrisin vetëdijësimin tek gratë dhe burrat mbi moshën 35 vjeçare në lidhje me parandalimin, simptomat dhe zhvillimin e diabetit. Ato do të masin sheqerin me glukometër dhe yndyrën e kolesterolit për të gjithë pjesëmarrësit, të cilët vijnë nga zonat rurale.	Ka ngritur vetëdijen tek gratë, burrat dhe të rinjtë për parandalimin, simptomat dhe zhvillimin e diabetit. Ndërsa, 91 pjesëmarrës

Organizata	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën	Rezultatet
				kanë përfituar shërbime falas nga Vita Jeta, me matjen e glikemisë dhe kolesterolit. Meqenëse diabeti trashëgohet, grave u është kërkuar të sjellin vajzat dhe mbesat e tyre në sesionet informuese, në mënyrë që të ngrisin vetëdijen e vajzave.
Shoqata e Grave Bletare "Okarina e Runikut"	Promovimi i punësimit për përfituesit e skemës së ndihmës	3,110€	54 përfitues 8 burra dhe 246 gra) tani janë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre të punës. Më shumë se 25 gra dhe vajza kanë marrë trajnim profesional. Hulumtimi u krye me 150 persona të anketuar në lidhje me	Është avokuar për rregulloret komunale për punësimin e grave në Drejtorinë e

Organizata	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën	Rezultatet
	sociale në rajonin e Drenicës		fuqizimin ekonomik të grave. Gjetjet iu drejtuan Zyrës për Barazi Gjinore dhe grave anëtare të parlamentit.	Zhvillimit Ekonomik. Kë, si dhe aktivitetet e tjera e rritën qasjen dhe ndikimin e grave dhe vajzave në proceset e vendimmarrjes.
Komiteti i Grave të Verbëra të Kosovës	Respektimi i të drejtave të grave të verbëra dhe me të pame të dëmtuar, të garantuara me ligj	2,832€	Ato do të adresojnë papunësinë në mesin e personave të verbër dhe me shikim të dëmtuar, veçanërisht grave dhe vajzave të verbëra; mosintegrimi i tyre në shoqëri; mosrespektimi i Ligjit për Personat e Verbër; dhe mungesa e sinjalizimeve për personat e verbër në transport. Ato do të zhvillojnë takime me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit, Komisionin	21 gra dhe vajza, anëtare të organizatës kanë dhënë rekomandime se si të përmirësojnë pozitën dhe situatën e personave të verbër, specifikisht

Organizata	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën	Rezultatet
			DNPPP dhe zyrtarë në komunat e Prishtinës, Mitrovicës dhe Ferizajit për të diskutuar më tej problemet me të cilat përballen personat e verbër dhe ata me shikim të dëmtuar, veçanërisht gratë e verbëra.	të grave dhe vajzave të verbëra në aspektin social.
Shoqata e Mamive të Kosovës	Promovimi i shëndetit të nënës dhe fëmijës përmes forcimit të rolit të mamisë	3,242€	Mbi 930 mami në Republikën e Kosovës nuk gëzojnë një status të veçantë krahasuar me profesionistët e tjerë shëndetësorë dhe roli i tyre nuk është përcaktuar në shërbimet shëndetësore. Kjo iniciativë do të krijojë një grup punues për të hartuar një koncept dokument mbi rolin e mamive në shërbimin shëndetësor dhe shëndetin e popullatës; Edhe 150 gra dhe vajza do të vetëdijësohen për shërbimet e ofruara nga mamitë, si dhe do të mobilizohen për t'i mirëpritur mamitë në mënyrë që mamitë t'i mbështesin ato në shëndetin e tyre. Projekt dokumenti për rolin e mamive në shërbimin shëndetësor dhe shëndetin e popullatës do t'i dërgohet	Së bashku me grupin punues, ShMK kanë draftuar një dokument mbi rolin e mamive në shërbimet shëndetësore dhe shëndetin e popullatës në përgjithësi. Ky draft dokument u është dërguar Komisionit

Organizata	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën	Rezultatet
			Komisionit Parlamentar për Shëndetësi dhe Ministrisë së Shëndetësisë.	Parlamentar për Shëndetësi.
Psikoterapeutët në Veprim	Shëndeti dhe trajtimi i sëmundjeve të heshtura tek gratë e moshës së tretë	3,537€	Projekti do të fokusohet në grupe të marginalizuara, përfshirë gratë dhe njerëzit me nevojë të veçanta të cilët nuk kanë mundësi të marrin kujdesin parësor. Ato do të përfshijnë 7 fshatra dhe do të organizojnë grupe punuese të udhëhequra nga profesionistët. Përveç kësaj , 70-100 persona të moshuar do të përfitojnë; 100 njerëz në nevojë do të ndihmohen përmes kontrollit të shtypjes së gjakut, sheqerit në gjak , sëmundjeve të frymëmarrjes. Ato do të avokojnë tek Drejtoria e Shëndetësisë në Gjilan për të premtuar angazhim konkret për shëndetin e grave të moshuara.	244 gra që ishin pjesëmarrëse në sesionet informuese kanë përfituar më shumë informata për kontrollat të gjakut, diabetit dhe sëmundje të frymëmarrjes. Derisa vajzat kanë përmirësuar njohuritë e tyre për rëndësinë e kujdesit shëndetësor dhe

Organizata	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën	Rezultatet
				se si të parandalojnë sëmundjet më të shpeshta.
Qendra për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës	Fuqizimi i grave viktime të dhunës me bazë gjinore përmes programeve të riintegrit	3,355€	Mungesa e programeve të riintegrit për gratë dhe fëmijët që kanë pësuar dhunë në familje i kufizon mundësitë e tyre për siguri dhe mbështetje të qëndrueshme, afatgjate. Projekti do të përfshijë hartimin e një dokumenti mbi programet aktuale të riintegrit. Do të vendoset një marrëveshje me institucionet e interesuara për trajtimin e kësaj çështje, bazuar në Strategjinë aktuale për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje si dhe në hulumtimin.	Kanë lansuar raportin hulumtues “Cfarë pas strehimores? Reintegrimi i grave dhe vajzave të mbijetuara të dhunës”. Ato kanë filluar me adresimin e rekomandimeve tek institucionet përkatëse.
Shoqata e Grave	Fuqizimi i Grave në	3,105€	Gratë janë të nënpërfaqësuar në tregun e punës. Në këtë projekt, do të identifikohen	45 raste të diskriminimit ndaj

Organizata	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën	Rezultatet
	Tregun e Punës		45 raste të diskriminimit ndaj grave dhe vajzave të reja në konkurset e punës dhe do të regjistrohen 5 biznese të reja të grave.	grave dhe vajzave në punë janë identifikuar. 20 gra dhe vajza janë trajnuar për intervista për punë dhe se si të përpilojnë ankesa pr shkak të diskriminimit në baza gjinore në punë.
Iniciativa e Pavarur e të Verbërve	Dua që të jetoj një jetë me dinjitet	2,955€	Projekti do të synojë adresimin e punësimit të ulët në mesin e personave të verbër, trajtimin e barabartë në rekrutimin dhe mbrojtjen e personave të verbër nga diskriminimi kur të realizojnë të drejtën e tyre për të pasur një punë. Iniciativa do të trajtojë një grup të synuar në përdorimin e teknologjisë dhe mundësive të kryerjes së	10 vajza dhe djem janë trajnuar në përdorimin e Microsoft Office. 12 vajza dhe djem janë trajnuar se si të përdorin një document të

Organizata	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën	Rezultatet
			praktikës. Do të përfshijë identifikimin e 4 ndërmarrjeve publike-private që mund të ofrojnë mundësi punësimi për të verbërit. Ato, gjithashtu, do të organizojnë takime avokimi me disa institucione lokale dhe kombëtare.	punësimi. Ato kanë nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi me ndërmarrjen komunale NTP Trafiku Urban, dhe dy përfituese janëpërfshirë në punë me pagese nga kjo ndërmarrje.
Qendra për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës “Raba Voca”	Thyeje heshtjen	3,351€	Projekti do të mundësojë që gratë, vajzat dhe burrat të ndërgjegjësohen dhe të mobilizohen për të drejtat e grave; 30 studentë drejtpërdrejtë dhe mbi 100 qytetarë në mënyrë indirekte do të	190 vajza, djem, burra dhe gra të etnive të ndryshme: Shqiptare,

Organizata	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën	Rezultatet
			informohen për barazinë gjinore dhe raportimin e dhunës përmes artit dhe një peme simbolike kundër dhunës, e cila do të vendoset në Mitrovicë.	Boshnjake, Serbe, Turke, Ashkali dhe Roma nga fshatrat e Vushtrisë, Skenderajit dhe Mitrovicës janë mbledhur për të ngritur vetëdijen e institucioneve dhe të komunitetit për të drejtat e grave dhe rëndësinë e luftimit të dhunës në baza gjinore.
Shoqata e të Verbërve dhe personave me të Pame të Dobësuar	Mbështetja e të Verbërve dhe personave me të Pame të Dobësuarve	2,982€	Ata do të adresojnë analfabetizmin midis të verbërve dhe personave me të pame të dobësuar. 12 persona të verbër do të certifikohen për shkollimin bazë dhe do të përgatiten më mirë për tregun e punës. Ata do të përfshihen në listën e punëkërkuësve.	12 vajza dhe djem janë certifikuar në alfabetin e Brailit. 12 gra dhe burra të verbër janë nënshkruar tek



Organizata	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën	Rezultatet
	për të bërë një jetë të pavarur			lista e personave që kërkojnë punë tek Agjencia për punësim.
Shoqata e Grave Femere "Krusha e Vogel"	Mbështetja e grave femere me subvencione	3,195€	Kjo iniciativë synon të mbështesë 12 gra femere me subvencione. Krusha e Vogel do të organizojë dy trajnime për: Si të etiketoni produktet tuaja, si të identifikoni tregjet fillestare të synuara, si të zgjidhni kanalet e shpërndarjes, si të shfrytëzoni fuqinë e publicitetit.	12 gra femere janë përkrahur me subvencione, derisa 30 gra dhe vajza janë informuar për hapat e veprimit për një arritje të suksesshme në biznes.
OJQ Drugëza	Përparimi i të drejtave të grave në pronë dhe fuqizimi i tyre ekonomik	2,136€	98 të rinj, kryesisht nxënës të shkollave të mesme në Komunën e Skenderajt, mësuan rreth të drejtave pronësore të grave dhe të drejtave të tjera përmes leksioneve. 300 gra dhe burra u informuan përmes broshurave mbi kornizën ligjore për të drejtat e pronës.	Rekomandime iu drejtuan Komunës së Skenderajt, Zyrës për Barazi Gjinore dhe Drejtorisë për

Organizata	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën	Rezultatet
				Punë dhe Mirëqenie Sociale.
OJQ Gruaja Hyjnore	Ngritja e vetëdijësimit të vajzave dhe grave për shëndetin riprodhues	2,995€	Iniciativa mblodhi vajza të moshave 12-25 vjeç, përfshirë vajzat rome, ashkali, egjiptiane, serbe dhe turke. Ato i bënë bashkë vajzat dhe nënat e tyre për të diskutuar për shëndetin e vajzave. Rekomandimet që dalin nga këto vizita në terren do t'i adresohen institucioneve lokale si: Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Spitalit Rajonal të Gjilanit. 20,000 përfitues indirektë do të informohen për qendrën e këshillimit, për atë çfarë ofron ajo dhe të marrin informacione në lidhje me shtatzënitë, higjienën gjinekologjike, infeksionet dhe çrregullimet menstruale, përmes fushatave të mediave sociale.	222 gra dhe vajza dhe 19 burra dhe djem janë vetëdijësuar për shqetësime të ndryshme sikurse shtatzënitë e padëshiruara, sëmundjet seksualisht të transmetueshme, infeksionet, cregullimet menstruale dhe qeshtje të tjera që lidhen me shëndetin e vajzave dhe grave.

Organizata	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën	Rezultatet
				Kjo është bërë përmes punëtorive të ndryshme, derisa nëmënyrë indirekte 7,183 persona kanë përfituar përmes fushatës në media sociale.
Qendra Rinore Lipjan	Mbështetja e vajzave dhe grave për pjesëmarrje aktive në ekonomi	2,940€	11 biznese të reja u bënë pjesë e bashkë-modelimit të modelit lokal dhe morën pjesë në politikën e paraparë me strategji.	Është hartuar një dokument i politikës publike, i cili identifikon mundësitë për mbështetjen e bizneseve të reja. Ky dokument iu përcoll Drejtorisë

Organizata	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën	Rezultatet
				për Zhvillim Ekonomik.
Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara - Handikos Mitrovicë	Përmirësimi i shkathësive të punësimit në mesin e të rinjve, vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara	2,785€	16 të rinj me aftësi të kufizuara mësuan se si të shkruajnë CV dhe letra përcjellëse, si dhe për aftësitë e prezantimit, ato ndërpersonale dhe të komunikimit. 23 persona me aftësi të kufizuara avokuan tek Zyra e Punësimit rreth pajtueshmërisë me Ligjin për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.	Përfituesit kanë zhvilluar shkathësi të buta, u bënë më të interesuar për vendet e lira të punës dhe shprehën gatishmërinë për të aplikuar për pozitat e punës që u përshtaten atyre.
Medica Kosova & Djepi i Buzëqeshjes	Mobilizimi i grave anëtare të parlamentit për të adresuar	6,295€	40 gra morën pjesë në sesione edukative të kombinuara me këshillime psikosociale. Ato janë të përgatitura që t'ua shprehin me fjalë nevojat e tyre grave anëtare të parlamentit. Seancat e mëtejshme edukative të	U ndërtua një bashkëpunim i midis grave nga institucionet lokale, posaçërisht

Organizata	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën	Rezultatet
	nevojat e grave të traumatizuara nga lufta		kombinuara me mbështetjen psikosociale kanë fuqizuar 60% të grave pjesëmarrëse për të tejkaluar stigmën dhe për të rritur vetëbesimin kur takohen me gratë deputete. Mbi 1000 qytetarë u informuan për rolin e grave në institucionet lokale, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të grave dhe bashkëpunimin midis grave dhe organizatave.	në Kuvendin Komunal, dhe grave në fshatra. Gratë janë më të përgatitura për të shprehur nevojat e tyre në Kuvendin Komunal në Gjakovë.

Shtojca Ib. Grantet e Fondit të Grave të Kosovës të alokuara për OShC-të në Ballkanin Perëndimor

Në vitin 2020, gjithsej 14 grante shtesë iu dhanë OShC-ve në rajon, të cilat kapin shumën prej 215,319 €.

Organizata / Shteti, Qyteti	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën
Rrjeti i Fuqizimit të Gruas Shqiptare, Tiranë, Shqipëri	Përparimi i të drejtave të grave në Punë përmes përmirësimit të qasjes në drejtësi	21,240€	Projekti synon të përparoj të drejtat e grave në punë duke ofruar ndihmë juridike dhe monitorim gjyqësor, përmes: 1. Monitorimit të rasteve gjyqësore në lidhje me diskriminimin, dokumentimin e rezultateve dhe përdorimin e gjetjeve për të informuar në lidhje me avokimin e institucioneve në mënyrë që të përmirësohet përgjigjia tyre; dhe 2. Fuqizimit dhe mbështetjes së grave të ndryshme për të raportuar diskriminimin me bazë gjinore në lidhje me punën.
Qendra për Zhvillim Komunitar "Sot për të Ardhmen",	Avokimi për përmirësimin e përgjigjes institucionale ndaj diskriminimit me	10,450€	Projekti synon të përmirësojë koordinimin dhe përgjigjen institucionale ndaj diskriminimit me bazë gjinore në punë duke u përqendruar në përmirësimin e harmonizimit institucional dhe forcimin e kapacitetit të institucioneve përgjegjëse, përmes: 1. Krijimit të Komitetit Ad-hoc për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Punë në Lezhë; 2. Ndërtimi

Organizata / Shteti, Qyteti	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën
Tiranë, Shqipëri	bazë Gjinore në Bashkinë e Lezhës		i kapaciteteve të anëtarëve për të adresuar, raportuar, koordinuar dhe menaxhuar rastet e diskriminimit në punë; 3. Krijimit të masave dhe nxjerrjes së rekomandimeve nga praktikatat në lidhje me diskriminimin në punë; 4. Organizimi i një tryeze të rrumbullakët në nivel lokal dhe qendror për të ndarë përvojat dhe rekomandimet për përmirësimin e përgjigjes institucionale ndaj diskriminimit me bazë gjinore në punë.
Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Tiranë, Shqipëri	Fuqizimi i grave dhe vajzave për të raportuar diskriminimin me bazë gjinore	11,229€	Projekti synon të forcojë rolin e grave dhe vajzave në tregun e punës dhe në luftimin e diskriminimit me bazë gjinore në Shqipëri, përmes: 1. Organizimit të takimeve me gra dhe vajza në terren në zonat rurale të Tiranës për diskriminimin me bazë gjinore në vendin e punës; 2. Organizimit të takimeve informuese me gratë dhe vajzat rreth në zonat urbane të Tiranës për diskriminimin me bazë gjinore; 3. Organizimit të punëtorive me të rinjtë për diskriminimin gjinor; 4. Organizimit të një fushatë sensibilizuese për diskriminimin gjinor në punë, përmes angazhimit të mediave tradicionale dhe atyre online.

Organizata / Shteti, Qyteti	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën
Fondacioni i Grave të Bashkuara, Banja Llukë, BeH	Përmirësimi i pozitës së grave në punësim dhe parandalimi i diskriminimit me bazë gjinore në Bosnje dhe Hercegovinë	22,201€	Projekti synon të përmirësojë pozitën e grave gjatë punësimit dhe të parandalojë diskriminimin me bazë gjinore në punë përmes: 1. Trajnimit për përfaqësuesit e OSHC-ve që ofrojnë ndihmë juridike falas për gratë; 2. Ofriimit të shërbimeve të ndihmës juridike falas grave që janë diskriminuar dhe/ose të cilave u janë shkelur të drejtat e punës; 3. Monitorimit dhe analizimit të procedurave gjyqësore në lëminë e marrëdhënieve të punës; 4. Avokimit publik të OShC-ve për përparimin e pozitës së grave në marrëdhëniet e punës.
Fondacioni Akademia për Gratë, Sarajevë, BeH	Ky është diskriminim, gjithashtu	10,000€	Projekti synon të rris ndërgjegjësimin e qytetarëve, institucioneve dhe akterëve të tjerë në lidhje me diskriminimin me bazë gjinore në punë dhe mundësitë për ta adresuar atë, përmes: 1. Zhvillimit të një fushate të në internet për diskriminimin ndaj grave; 2. Takimeve me gratë, rritjes së ndërgjegjësimit për nevojën e solidaritetit midis grave, punonjësve të tregtisë; 3. Takimeve me menaxhmentet e zinxhirëve tregtarë Bingo, Mercator dhe Konzum për të rritur ndërgjegjësimin për diskriminimin ndaj grave; 4. Prezantimit të hulumtimit dhe avokimit në

Organizata / Shteti, Qyteti	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën
			Institucionin e Avokatit të Popullit për të Drejtat e Njeriut dhe në Parlamentin e BeH.
Instituti i Kosovës për Drejtësi, Prishtinë, Kosovë	Përmirësimi i të drejtave të grave në punë	22,950€	Projekti synon të përmirësojë të drejtat e grave në punë përmes ofrimit të ndihmës juridike falas dhe monitorimit gjyqësor të rasteve në mënyrë që të parandalohet sjellja diskriminuese dhe të përmirësohet drejtësia, përmes: 1. Zhvillimit të hulumtimit dhe monitorimit të gjykatës; 2. Ofrimit të ndihmës juridike dhe shërbimeve falas për gratë që duan të raportojnë diskriminimin në lidhje me të drejtat e tyre të punës; 3. Krijimit të koordinimit me Institucionin e Ombudspersonit; 4. Prodhimit të dy video rrëfimeve të shkurtra nga monitorimi i seancave gjyqësore; 5. Publikimit të raportit përfundimtar për punën e policisë, prokurorive, të gjykatave, inspektoratit të punës dhe Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil në Kosovë në trajtimin e të drejtave të grave në punë ; 6. Rritja e ndërgjegjësimit në mesin e qytetarëve për gjetjet e raporteve të monitorimit.
Qendra Kosovare për	Parandalimi i të gjitha formave të	11,453€	Projekti synon të përmirësojë të drejtat e grave në punë dhe të fuqizojë gratë të kërkojnë të drejtat e tyre duke u

Organizata / Shteti, Qyteti	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën
Studime Gjinore, Prishtinë, Kosovë	diskriminimit në vendin e punës		ofruar atyre më shumë informacione mbi legjislacionin kundër-diskriminim, përmes: 1. Prodhimit të një raporti mbi qëndrimet që do të përdoret si bazë e politikës së ndërhyrjes dhe avokimit; 2. Takimeve për avokim; 3. Një fushate ndërgjegjësuese të zhvilluar për informimin e shoqërisë Kosovare për konceptet e diskriminimit, format e ngacmimit seksual, si dhe mekanizmat dhe procedurat për trajtimin e tij kur ai ndodh në vendin e punës.
Sindikata e Mediave të Malit të Zi, Podgoricë, Mali i Zi	Barazia përmes Drejtësisë: Rastet e diskriminimit në lidhje me punën	21,500€	Projekti synon të zvogëlojë diskriminimin me bazë gjinore ndaj grave në lidhje me punën në Mal të Zi përmes: 1. Monitorimit të rasteve të diskriminimit me bazë gjinore ndaj grave në punë para Gjykatave Themelore në Podgoricë, Bijelo Polje dhe Kotor; 2. Themelimit të mekanizmit të ndihmës juridike falas për gratë viktime të diskriminimit gjinor në lidhje me punën në Mal të Zi; 3. Zhvillimit të studimeve / publikimeve për rastet e diskriminimit me bazë gjinore ndaj grave në lidhje me punën në Mal të Zi; 4. Prezantimit të rezultateve të projektit dhe zbatimit të një fushatë; 5. Rritjes së

Organizata / Shteti, Qyteti	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën
			kapacitetit organizativ dhe duke ridizajnuari faqen në internet.
Shoqata e të Rinjve me Aftësi të Kufizuara, Podgoricë, Mali i Zi	I fuqizuar, I punësuar, I përfshirë	9,997€	Projekti synon të përmirësojë pozitën e grave me aftësi të kufizuara në fushën e punës dhe punësimit në Mal të Zi përmes: 1. Krijimit të broshurave për të drejtat në lidhje me punën dhe punësimin e grave me aftësi të kufizuara; 2. Ofrimit të ndihmës juridike falas për gratë me aftësi të kufizuara; 3 Punëtorive me gratë me aftësi të kufizuara për të drejtën e punës dhe punësimit; 4. Ditës informuese me punëdhënës për punësimin e grave me aftësi të kufizuara; 5. Fushatës mediatike për rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me të drejtat e grave me aftësi të kufizuara për punësim.
Komiteti i Helsinkit për të Drejta të Njeriut i Republikës së Maqedonisë, Shkup,	Punonjëse Gra Bashkohuni	21,299€	Projekti synon të zvogëlojë diskriminimin gjinor dhe ndër-sektorial ndaj grave në vendin e punës përmes: 1. Sigurimit të ndihmës juridike në rastet e diskriminimit ndaj grave në vendin e punës; 2. Monitorimit të procedurave të diskriminimit ndaj grave në vend të punës; 3. Informimit të grave për njohjen dhe raportimin e diskriminimit ndaj grave në punë, si dhe ngritjes së vetëdijes dhe informimit të publikut në lidhje me gjendjen e diskriminimit ndaj grave

Organizata / Shteti, Qyteti	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën
Maqedoni e Veriut			në punë, përfshirë prodhimin e grafikëve informues tremujor.
Shoqata e Qytetarëve Punonjës të Tekstilit, Lëkurës, dhe Këpucëve, Shtip & Shkup, Maqedoni e Veriut	Promovimi i të Drejtave të Punëtorëve të Tekstilit nga Rajoni Lindor	10,973€	Projekti synon të rrisë dhe përmirësojë njohuritë rreth diskriminimit me bazë gjinore midis punëtorëve dhe të institucionalizojë trajnimin mbi diskriminimin me bazë gjinore në Mekanizmat Lokalë në Komunën e Shtipit, përmes: 1. Krijimit të një broshure për ta bërë më të lehtë për punonjësit e tekstilit identifikimin dhe raportimin e diskriminimit dhe trajtimit të pabarabartë në vendin e tyre të punës; 2. Angazhimit të një avokati për të këshilluar dhe përpiluar ankesa që dorëzohen në institucionet dhe komitetet kompetente; 3. Mbajtjes së një sesiioni edukativ me punonjësit e tekstilit dhe përfaqësuesit e Avokatit të Popullit mbi temën e diskriminimit në vend të punës, jashtë qytetit të Shtipit; 4. Krijimit dhe shtypjes së një buletini për mbrojtjen nga diskriminimi me bazë gjinore dhe shkeljet e të drejtave të grave punonjëse; 5. Nxitjes së rezultateve përmes rekomandimeve.
Shoqata e Viktimologjisë	Njihni diskriminimin gjinor, identifikoni	22,342€	Projekti synon të rrisë ndikimin e OSHC-ve në mbajtjen e institucioneve përkatëse përgjegjëse për zbatimin e ligjeve



Organizata / Shteti, Qyteti	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën
e Serbisë, Beograd, Serbi	shkeljet e e Ligjit të punës dhe punësimit! Reago!		kundër-diskriminit në lidhje me të drejtat e grave për të punuar dhe për të fuqizuar gratë që të kërkojnë të drejtat e tyre, duke: 1. Krijuar dhe shtypur një udhëzues: Si, ku dhe kujt mund t'i drejtohen gratë për shkeljet e të drejtave ?; 2. Shpërndarë dhe prezantuar udhëzuesit në gjashtë qytete të Serbisë përmes takimeve rajonale me përfaqësuesit relevant; 3. Mbështetur gratë të cilave u është shkelur e drejta e punës dhe e punësimit përfshirë diskriminimin gjinor; 4. Monitoruar procedurat gjyqësore në lidhje me diskriminimin gjinor dhe shkeljet e të drejtave në lidhje me punën dhe punësimin; 5. Analizuar përmbledhjet nga takimet rajonale dhe adresuar problemet e identifikuara.
Iniciativa A II – për të Drejtat Ekonomike dhe Sociale, Beograd, Serbi	Përmirësimi i praktikave institucionale për parandalimin e diskriminimit ndaj grave në tregun e punës në Serbi	9,930€	Projekti synon të përmirësojë mbrojtjen nga diskriminimi për gratë që përballen me diskriminim të shumëfishtë në Serbi, duke përmirësuar kornizën ligjore, strategjike ose praktike të zbatueshme në këtë lëmi, përmes: 1. Shqyrtimit të përdorimit të juridiksionit në lidhje me zbatimin e dispozitave kundër-diskriminim të Ligjit të Punës; 2. Krijimi i një plani avokimi bazuar në problemet e

Organizata / Shteti, Qyteti	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën
			identifikuara nga gratë të cilat diskriminohen në punë; 3. Monitorimi i pozitës dhe progresit të statusit të punësimit të banorëve të zgjedhur të vendbanimeve joformale që janë zyrtarisht të papunë dhe / ose kërkojnë punësim në mënyrë aktive përmes Shërbimit Kombëtar të Punësimit; 4. Vendosija e marrëdhënieve me institucionet relevante për të përmirësuar rregulloret, praktikat dhe politikat publike për mbrojtjen e grave nga diskriminimi në punë ose në lidhje me punën; 5. Zhvillimi i një fushate për informimin dhe për të marrë mbështetjen nga qytetarët për ndryshimet përkatëse në kornizën ligjore, strategjike ose praktike në lidhje me mbrojtjen e grave nga diskriminimi në punë ose në lidhje me punën.
ROZA Shoqata për të Drejtat e Grave në Punë, Zrenjanin, Serbi	Çfarë më pret në tregun e punës	9,754€	Projekti synon të përmirësojë njohuritë e popullatës në lidhje me diskriminimin në tregun e punës dhe të drejtat e punës përmes: 1. Organizimit të punëtorëve edukuese për të rritur vetëdijësimin e grave në lidhje me diskriminimin me bazë gjinore lidhur me punën; 2. Organizimit të punëtorëve për të rritur vetëdijësimin e vajzave rreth diskriminimit me bazë gjinore në lidhje me punën; 3.



Organizata / Shteti, Qyteti	Titulli i projektit	Shuma	Informata për iniciativën
			Organizimi i tryezave të rrumbullakëta në bashkëpunim me gratë dhe të rinjtë lidhur me të drejtat e tyre të punës; 4. Organizimit të një fushate për të rritur ndërgjegjësimin e publikut.

Shtojca 2. Të arriturat e Avokimit nga Lobi për Barazi Gjinore në Kosovë në vitin 2020

#	Grupi	Iniciativat avokuese	Rezultatet e arritura	Politikat Publike të ndryshuara	Numri i iniciativave avokuese
1	Shtime	1) Fushatë vetëdijësuese për muajin kundër kancerit të gjirit 2) Fushatë vetëdijësuese për të drejtat e grave në pronë 3) Avokimi për të rritur numrin e grave përfituese të granteve	2	1	3
2	Malishevë	1) Avokimi për shërbimet shëndetësore për gratë 2) Avokimi për ofrimin e shërbimeve psikologjike në shkolla 3) Fushatë vetëdijësuese për fenomene negative tek të rinjtë	0	2	3
3	Dragash	1) Avokimi për punësimin e grave	0	0	1
4	Viti	1) Avokimi për përfshirjen e grave në pozita vendim-marrëse 2) Avokimi për fuqizimin ekonomik të grave 3) Rritja e vetëdijësimit për subvencionet për gratë	2	2	4

		4) Avokimi për përfshirjen e grave në këshillat lokal			
5	Lipjan	1) Avokimi për punësimin e grave	1	0	1
6	Drenas	1) Rritja e ndërgjegjësimit për çështjet shëndetësore 2) Avokimi për përfshirjen e grave në biznes 3) Avokimi për adresimin e dhunës me bazë gjinore që ka ndodhur gjatë pandemisë 4) Rritja e vetëdijësimit për fenomene negative tek të rinjtë	2	0	4
7	Prishtinë	1) Avokimi për përfshirjen e grave në procese vendim-marrëse 2) Avokimi për përfshirjen e vajzave në edukim/arsim 3) Rritja e vetëdijësimit për trafikimin e grave	1	2	3
8	Gjakovë	1) Rritja e vetëdijësimit për dhunën në familje të kryer gjatë pandemisë 2) Avokimi për kujdesin mendor gjatë pandemisë	1	0	2
9	Mitrovicë	1) Rritja e vetëdijësimit për kancerin e gjirit 2) Avokimi për strehimore për gra dhe fëmijë 3) Avokimi për strehimore për persona me aftësi të kufizuar 4) Avokimi për mbështetje për klubin sportiv të grave	2	0	4
10	Istog	1) Avokimi për punësimin e grave	0	0	1

11	Fushe Kosovë	1) Rritja e vetëdijësimit lidhur me kancerin e gjirit	1	1	1
12	Novoberdë	1) Avokimi për vetëdijësimin në lidhje me dhunën në familje gjatë pandemisë	0	0	1
13	Mamushë	1) Rritja e vetëdijësimit për dhunën në familje 2) Avokimi për punësimin e grave 3) Njoftimi i grave lidhur me fazat e ngrijës së biznesit	1	0	3
14	Kllokot	1) Avokimi për të drejtat e grave në trashëgimi dhe pronë 2) Rritja e vetëdijësimit për çështje shëndetësore gjatë pandemisë	1	0	2
15	Suharekë	1) Avokimi për të drejtat e grave në trashëgimi dhe pronë 2) Rritja e vetëdijësimit për rëndësinë e ndërtimit të qendrave ditore të fëmijëve	0	2	2
16	Kamenicë	1) Rritja e ndërgjegjësimit në lidhje me kancerin e gjirit	2	0	3

		2) Avokimi për një klinikë mobile të mamografisë e cila do të jetë në dispozicion për 20 ditë për të ofruar kontrolle shëndetësore për gratë në komunë 3) Avokimi për ndërtimin e objektit të Gjinekologjisë			
17	Klinë	1) Avokimi për përfshirjen e më shumë grave në këshillat lokal të komuniteteve	1	0	1
18	Gjilan	1) Rritja e vetëdijësimit për dhunën në familje gjatë pandemisë 2) Avokimi për punësimin e grave 3) Avokimi për shëndetin e grave	2	0	3
19	Pejë	1) Ka avokuar për krijimin e mekanizmave koordinues për parandalimin e dhunës me bazë gjinore	1	1	1
Totali			20	11	43



Rrjeti i Grave të Kosovës
Rr.Kadri Gjata (ish Feriz Blakçori), kati i 2-të, nr. 8
10000 Prishtinë, Kosovë
+381 (0) 38 245 850
www.womensnetwork.org
info@womensnetwork.org
[Facebook: Kosova Women's Network](https://www.facebook.com/Kosova-Women's-Network)

